


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBETARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NR. 1271 REP.
NR. 567 KOL.



MARRËVESHJE SIGURUESE

Sot më datë 14.07.2019, përpara meje, Noteres Vlora V. Shllava, anetare e Dhomës se Noterisë Tiranë, me Zyrë Notoriale në Tirane Dr. G. Fashën, u paraqitën palët si më poshtë:

BARRËDHËNËSI: Z. Mihal Hudhra, shtetas shqiptar, i biri i Miti dhe i Galini, lindur në 07.11.1953, ne Vlore, banues në Tirane, Letërnjoftimit me Nr. F31107012C (më poshtë referuar si "Barrëdhënësi").

Znj. Vojsava Hudhra, shtetase shqiptare, e bija e Kasem dhe e Hatije, lindur në Fier, më dt. 02.10.1953, banuese në Tirane, mbajtëse e Letërnjoftimit me Nr. F36002014A (më poshtë referuar si "Barrëdhënësi").

dhe,

BARRËMARRËSI: "INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA" SHA, me Numer Unik te Identifikimit (NIPT) J81817006P, regjistruar me Vendim nr. 19460, datë 19.05.1998, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me seli në Rr. Ismail Qemali, nr. 27, Tirana, Shqipëri, e përfaqësuar prej Z. Olsi Kota, shtetas shqiptar, lindur më 04.02.1984 në Tirane, me Letërnjoftim Nr. I40204028V dhe nga Zj. Jonida Cule, shtetase shqiptare, lindur ne Tirane, me 30.05.1983, identifikuar me nr. personal I35530152N, ne cilësinë e përfaqësuesve te Bankes (më poshtë referuar si "Barrëmarrësi").

me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilëve, unë noterja jam e sigurt, të cilët më deklaruan se:

Meqënenëse:

- A. Barrëmarrësi në cilësinë e Kredidhënësit ka lidhur me Kredimarrës: "ELVA 2001" SHPK (këtu e më poshtë referuar si "Kredimarrësi") Kontratën e Kredisë Bankare nr. 1267 rep./ nr. 563 kol., datë 14.07.2019 (këtu e më poshtë referuar si "Kontrata e Kredisë"), me shumë principali LEKE 125,000,000 (njëqind e njezete e pese milion) (këtu e më poshtë referuar si "Principali");
- B. Për qëllime të garantimit të shlyerjes së detyrimeve që lindin për 'Kredimarrësin' nga 'Kontrata e Kredisë', kërkohet barrë siguruese në favor të Barrëmarrësit mbi kolateralin – objekt të kësaj marrëveshje siguruese;

Atëherë,

Palet, me vullnet të lirë dhe të plotë, bien dakort të lidhin këtë Marrëveshje Siguruese me përbajtjen si më poshtë vijon:

Neni 1 - Përkufizime

1.1 Kudo, ku përdoren në këtë Marrëveshje Siguruese, dhe vetëm nëse shprehimisht parashikohet ndryshe, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet e mëposhtme:

Jasll *Hudra*

C

- “Kolateral” – nënkuption pasurinë e luajtshme (të prekshme apo të paprekshmë), objekt i kësaj Marrëveshje Siguruese. Kolaterali mund të ekzistojë ose mund të krijohet në të-ardhmen dhe nuk kufizohet vetëm me pasuritë e luajtshme mbi të cilat Barrëdhënsi ka pronësi apo një të drejtë të tashme. Kolaterali mund të ndodhet kudo, brenda apo jashtë Shqiperisë, dhe përfshin edhe të ardhurat kolateral. Përshkrimi i Kolateralit jepet në nenin 2.1 të kësaj Marrëveshje Siguruese.
- “Barrë Siguruese” – nënkupton të drejtën reale mbi ‘Kolateralin’, nëpërmjet se cilës sigurohet përbushja e detyrimeve të rrjedhura për ‘Kredimarrësin’ nga ‘Kontrata e Kredisë’.
- “Detyrime të Siguruara” – nënkupton detyrimin, që ka ‘Kredimarrësi’ për të përbushur të gjitha detyrimet sipas ‘Kontratës së Kredisë’, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në pagimin e shumës totale të ‘Principalit’, interesave dhe penaliteteve deri në ditën e shlyerjes totale të të gjitha detyrimeve të ‘Kredimarrësit’, së bashku më çdo shumë tjeterë sipas ‘Kontratës së Kredisë’, si dhe pagimin e çdo shpërblimi, shpenzimi, ose pagesa të tjera të lidhura me ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimeve të ‘Kredimarrësit’ sipas ‘Kontratës së Kredisë’ dhe Legislacionit Shqiptar.
- Sipas Ekstraktit te leshuar nga Qendra Kombetare e Regjistrimit, Barredhenesi Z. Mihal Hudhra, rezulton ortak ne shoqerine: “ELVA 2001” Shpk regjistruar ne Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombetare e Regjistrimit me Numer Unik te Identifikimit (NIPT) K12809402J. Barredhenesi eshte zoterues i 50% (pesedhjete perqind) te vleres se kapitalit themeltar te shoqerise “ERPA INVEST” SHPK;
- Sipas Ekstraktit te leshuar nga Qendra Kombetare e Regjistrimit, Barredhenesi Zj. Vojsava Hudhra, rezulton ortake ne shoqerine: “ELVA 2001” Shpk regjistruar ne Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombetare e Regjistrimit me Numer Unik te Identifikimit (NIPT) K12809402J. Barredhenesi eshte zoterues i 50% (pesedhjete perqind) te vleres se kapitalit themeltar te shoqerise “ERPA INVEST” SHPK;
- Sipas Ekstraktit te leshuar nga Qendra Kombetare e Regjistrimit, Barredhenesi Z. Mihal Hudhra, rezulton ortak ne shoqerine: “HEC KOTKA” Shpk regjistruar ne Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombetare e Regjistrimit me Numer Unik te Identifikimit (NIPT) L82002021J. Barredhenesi eshte zoterues i 100% (njëqind perqind) te vleres se kapitalit themeltar te shoqerise “HEC KOTKA” SHPK;
- Sipas Ekstraktit te leshuar nga Qendra Kombetare e Regjistrimit, Barredhenesi Zj. Vojsava Hudhra, rezulton ortake ne shoqerine: “TOER ENERGY” Shpk regjistruar ne Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombetare e Regjistrimit me Numer Unik te Identifikimit (NIPT) L71422032S. Barredhenesi eshte zoterues i 50% (pesedhjete perqind) te vleres se kapitalit themeltar te shoqerise “TOER ENERGY” SHPK;
- Sipas Ekstraktit te leshuar nga Qendra Kombetare e Regjistrimit, Barredhenesi Zj. Vojsava Hudhra, rezulton ortake ne shoqerine: “TOER ENERGY” Shpk regjistruar ne Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombetare e Regjistrimit me Numer Unik te Identifikimit (NIPT) L71422032S. Barredhenesi eshte zoterues i 50% (pesedhjete perqind) te vleres se kapitalit themeltar te shoqerise “TOER ENERGY” SHPK;

Neni 2 - Barra Siguruese

2.1. Me qëllim që të sigurojë ekzekutimin e plotë të ‘Detyrimeve të Siguruara’ të rrjedhura për ‘Kredimarrësin’ nga ‘Kontrata e Kredisë’, secili nga ‘Barrëdhënsi’, nëpërmjet kësaj Marrëveshje Siguruese, vendos në favor të ‘Barrëmarrësit’, ‘Barrë Siguruese’ te rrades se pare mbi ‘Kolateralin’ e përshkruar më poshtë:

- 50% (pesedhjete perqind) te kuotave te kapitalit themeltar zoteruar nga ortaku Mihal Hudhra pranë shoqërisë “ELVA 2001” Shpk si dhe çdo te drejte, titull dhe interes lidhur me to;

- 50% (pesedhjete perqind) te kuotave te kapitalit themeltar zotëruar nga ortaku Vojsava Hudhra pranë shoqërisë "ELVA 2001" Shpk si dhe çdo te drejte, titull dhe interes lidhur me to;
- 100% (njeqind perqind) te kuotave te kapitalit themeltar zotëruar nga ortaku Mihal Hudhra pranë shoqërisë "HEC KOTKA" Shpk si dhe çdo te drejte, titull dhe interes lidhur me to;
- 50% (pesedhjete perqind) te kuotave te kapitalit themeltar zotëruar nga ortaku Mihal Hudhra pranë shoqërisë "TOER ENERGY" Shpk si dhe çdo te drejte, titull dhe interes lidhur me to;
- 50% (pesedhjete perqind) te kuotave te kapitalit themeltar zotëruar nga ortaku Vojsava Hudhra pranë shoqërisë "TOER ENERGY" Shpk si dhe çdo te drejte, titull dhe interes lidhur me to;

2.2. 'Barra Siguruese' e krijuar sipas kesaj Marreveshje do të jetë detyruese e do të imbetet në fuqi për 'Barrëdhënësin', pasardhësit e tij apo posedues dhe përfitues të tjerë të kolateralit, dhe do të përbëjë një garanci të panderprerë, pavarësisht nga shlyerja e pjesshme e 'Detyrimeve te Siguruara' dhe nuk do të cënohet nga ndonjë barrë, garanci apo mjet tjetër sigurimi të vendosur në favor të 'Barrëmarrësit' nga 'Barrëdhënësi' apo të tretë.

Neni 3 – Regjistrimi i Barrës Siguruese

3.1. Nëpërmjet kësaj Marrëveshje Siguruese, 'Barrëdhënësi' jep miratimin e tij, që sipas gjykimit dhe vendimit të vetëm të 'Barrëmarrësit', 'Barra Siguruese' e krijuar me këtë Marrëveshje Siguruese, të regjistrohet nga 'Barrëmarrësi' me shpenzimet e 'Barrëdhënësit', në Regjistrin e Barrëve Siguruese, në përputhje me Ligjin nr. 8573, datë 18.10.1999 "Për Barrët Siguruese".

3.1.1. Përveç regjistrimit në Regjistrin e Barrëve Siguruese, 'Barrëdhënësi' jep miratimin e tij, që sipas gjykimit dhe vendimit të vetëm të 'Barrëmarrësit', 'Barra Siguruese' dhe/ose kjo 'Marrëveshje Siguruese' të regjistrohet, me shpenzimet e 'Barrëdhënësit', edhe në regjistra apo regjistrarë kompetentë, nëse në varësi të llojit të 'Kolateralit', një regjistrim i tillë është i nevojshëm sipas legjislacionit të zbatueshëm.

3.1.2. Barredhenesi do te regjistroje menjehere kete 'Marrëveshje Siguruese'ne Regjistrin e Ortakeve dhe ne Regjistrin Tregtar mbajtur nga Qendra Kombetare te Biznesit si dhe do te paraqese prane Bankes ekstraktin qe verteton kryerjen regjistrimit;

3.2. 'Barrëdhënësi' kupton plotësisht dhe bie dakord se nëse 'Barrëmarrësi' është ose vihet në posedim të 'Kolateralit', atëherë përfektive të preferimit kundrejt të tretëve sipas Ligjit nr. 8573, datë 18.10.1999 "Për Barrët Siguruese", barra siguruese do të konsiderohet e komplektuar edhe me anë të vendosjes së 'Barrëmarrësit' në posedim të 'Kolateralit'.

3.3. 'Barrëmarrësi' merr përsipër se do të bëjë të mundur heqjen e barrës siguruese mbi 'Kolateralin', vetëm pas përbushjes së plotë të të gjitha 'Detyrimeve të Siguruara'.

3.4. 'Barrëdhënësi' i jep të drejtë 'Barrëmarrësit', që me shpenzimet e 'Barrëdhënësit' të térheqë nga organet kompetente, në çdo moment dokumentacionin provues të regjistrimit të 'Barrës Siguruese', ose vërtetimet mbi gjëndjen juridike të 'Kolateralit'.

Neni 4 – Deklarime dhe Garanci të 'Barrëdhënësit'

4.1. 'Barrëdhënësi' deklaron dhe garanton 'Barrëmarrësin', se mbi 'Kolateralin' objekt të kësaj Marrëveshje Siguruese, nuk rëndon asnjë barrë siguruese (përvec sa shprehimisht parashikohet në këtë Marrëveshje Ssiguruese) në lidhje me ndonje detyrim tjetër, dhe se 'Barrëdhënësi' është titullari i vetëm i pronësisë mbi 'Kolateralin'.

4.2. 'Barrëdhënësi' merr përsipër, që deri në momentin e shlyerjes së plotë të të gjitha 'Detyrimeve të Siguruara', të mos kryejë mbi 'Kolateralin' asnjë veprim juridik barrësimi, tjetësimi, disponimi (material apo juridik), ndarje, bashkimi, pjestimi, pa pëlqimin paraprak me shkrim të 'Barrëmarrësit'.

4.3. 'Barrëdhënësi' kupton plotësisht dhe pranon që në qoftë se 'Kolaterali' humbet ose dëmtohet qoftë dhe përfaktor, në mënyrë që të mos dëmtohen të drejtat e 'Barrëmarrësit', kjo e fundit mund

të kërkojë nga 'Barrëdhënësi', që t'i jepet garanci e plotë mbi sende të tjera dhe, në mungesë të saj, mund të kërkojë pagesën e menjëherëshme të detyrimeve të rrjedhura nga 'Kontrata e Kredisë'. I njëjtë rregullim do të jetë i zbatueshëm edhe nëse 'Barra Siguruese' humbet ose cënohet pjesërisht apo totalisht, nga ndonjë e metë juridike e titullit të pronësisë apo e statusit juridik të 'Kolateralit'.

4.4. 'Barrëdhënësi' kuption plotësisht dhe pranon që në rast të fillimit nga ana e 'Barrëmarrësit' të procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm për detyrimet e 'Kredimarrësit' të rrjedhur nga 'Kontrata e Kredisë', 'Kolaterali' sipas gjykimit dhe diskrecionit të vetëm të 'Barrëmarrësit' do t'i nënshtronhet procesit të ekzekutimit të detyrueshëm, pavarësisht nëse kanë filluar ose jo procedurat përmbarimore edhe mbi pasuritë e tjera të luajtshme apo të paluajtshme të 'Kredimarrësit', ose Dorezanësit(ve), që mbi pasuri tjetër të vendosur në hipotekë apo në barrë siguruese në favor të 'Barrëmarrësit' si garanci për shlyerjen e 'Detyrimeve të Siguruara'.

4.5. 'Barrëdhënësi' deklaron se kuption plotësisht, dhe bie dakord që, 'Barra Siguruese' e krijuar në bazë të kësaj Marrëveshje Siguruese, duke qënë një e drejtë reale me titullar 'Barrëmarrësin', nuk do të cënohet apo preket, pavarësisht nëse 'Barrëmarrësi' dhe 'Kredimarrësi' vendosin të ndryshojnë kushtet e 'Kontratës së Kredisë' dhe për këtë qëllim nënshkruajnë me njëra – tjetrën amëndamente të 'Kontratës së Kredisë'.

4.6. 'Barrëdhënësi' deklaron se kuption plotësisht që kjo Marrëveshje Siguruese përbën titull ekzekutiv dhe se nëse ndodh një 'Rast Shkakësor' sikundër përcaktohet në 'Kontratën e Kredisë', atëherë 'Barrëmarrësi' sipas vendimit dhe diskrecionit të vetëm të tij, do të mund të fillojë kërkimin e shlyerjes së 'Detyrimeve te Siguruara' nëpërmjet ekzekutimit të detyrueshëm të 'Kolateralit', duke u bazuar në Ligjin nr. 8573, datë 18.10.1999 "Për Barrët Siguruese", si dhe në "Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë".

Neni 5 - Detyrime të Barrëdhënësit

5.1. 'Barrëdhënësi' do të përbushë të gjitha detyrimet e parashikuara për të, në këtë Marrëveshje Siguruese dhe legjislacionin në fuqi, si dhe do të respektojë cdo deklarim dhe garanci të dhënë në këtë Marrëveshje Siguruese.

5.2. 'Barrëdhënësi' do të mbajë 'Kolateralin' në kushte të mira dhe do të kryejë të gjitha riparimet e nevojshme të tij, dhe nuk do të kryejë apo lejojë asnjë humbje apo dëmtim material të 'Kolateralit'.

5.3. Nëse do t'i kërkohet nga ana e 'Barrëmarrësit', 'Barrëdhënësi' do të sigurojë 'Kolateralin' në favor të 'Barrëmarrësit', për të gjithë shumën e 'Principalit' dhe për të gjithë kohëzgjatjen e 'Kontratës së Kredisë', përkundrejt çdo lloj rreziku që do t'i kërkohet nga ana e 'Barrëmarrësit'.

5.4. 'Barrëdhënësi' garanton 'Barrëmarrësin' lidhur me vlefshmérinë e 'Barrës Siguruese' të krijuar në favor të 'Barrëmarrësit' në bazë të kësaj Marrëveshje Siguruese, si dhe përkundrejt çdo të mete juridike që mund të cënojë 'Barrën Siguruese'. Në këtë kuadër, 'Barrëdhënësi' detyrohet të marrë pjesë në gjykimin e cdo çështje gjyqësore në mbrojtje të interesave të 'Barrëmarrësit', dhe zgjidhë konfliktin në favor të 'Barrëmarrësit'. Në rast se 'Barrëmarrësit' i cënohet 'Barra Siguruese', qoftë pjesërisht apo edhe tërësisht, atëherë 'Barrëdhënësi' do të jëtë i detyruar personalisht me të gjithë pasurinë e vet të luajtshme apo të paluajtshme, për shlyerjen e detyrimeve të 'Kredimarrësit' të rrjedhura nga 'Kontrata e Kredisë'.

5.5. Në rast se persona të tretë pretendojnë të drejta pronësie, posedimi, uzufrukti, ensiteoze, apo të drejta përdorimi ose ndonjë të drejte tjeter reale, 'Barrëdhënësi' garanton se do të ruajë të pacënuar 'Barrën Siguruese' të 'Barrëmarrësit' mbi 'Kolateralin'.

5.6. 'Barrëdhënësi' do të pranojë dhe lejojë punonjësit e 'Barrëmarrësit', që me kërkësen e tyre, të inspektojnë dhe monitorjnë gjëndjen e 'Kolateralit'. Gjithashtu, 'Barrëdhënësi' bie dakord dhe pranon, që nëse do të kërkohet nga 'Barrëmarrësi' rivlerësimi i 'Kolateralit' nga ekspertë vlerësues, të lëajojë kryerjen e rivlerësimit si dhe të mbulojë shpenzimet e lidhura me rivlerësimin përkundrejt ekspertit vlerësues të perzgjedhur nga 'Barrëdhënësi' nga lista e publikuar e Vlerësuesve të Jashtëm që Banka i vë në dispozicion.

Neni 6 – Të ndryshme

6.1. Çdo njoftim ose kërkësë do të konsiderohet i kryer kur bëhet me shkrim dhe dërgohet në adresat e parashikuara për palët në këtë Marëveshje Siguruese.

6.2. Në rast se ndonjë klauzolë ose detyrim sipas kësaj Marëveshje Siguruese do të jetë apo shpallet e pavlefshme, e kundërligjshme ose e pazbatueshme, - vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e klauzolave ose e detyrimeve të tjera të parashikuara në këtë Marëveshje Siguruese, nuk do të çenohen apo ndikojnë në zbatim.

6.3. Në zbatim të nenit 127 të Ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar Vendimit nr. 67 datë 13.10.2010 "Për miratimin e Rregullores "Për përbajtjen e informacionit dhe funksionimin e regjistrat te kredive në Bankën e Shqipërisë" të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, 'Barrëdhënësi' nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Marëveshje Siguruese: (i) deklaron se i gjithë informacioni i dhënë prej tij është i saktë dhe i plotë, si dhe (ii) duke kuptuar se, të dhënat demografike dhe financiare të ruajtura në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë do të trajtohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënavë personale, sekretin bankar si dhe sekretin profesional, si dhe për faktin se "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA dhe Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar trajtimin e sigurt të të dhënavë të 'Barrëdhënësit', autorizon "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA, që për qëllimet që përfshijnë: 1. vlerësimin e aplikimit të 'Kredimarrësit' për të marrë kredi; 2. vlerësimin e rrezikut të kredisë gjatë të gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies kontraktore të kredisë së 'Kredimarrësit' me "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA; 3. vlerësimin e besueshmërisë së 'Kredimarrësit' së bashku me personat e tretë të lidhur me 'Kredimarrësin'; të njihet me detyrimet e 'Barrëdhënësit' ndaj bankave/degëve të bankave të huaja/subjekteve kredidhënëse, nëpërmjet përpunimit të autorizuar të të dhënavë/informacionit të Regjistrat të Kredive, në mënyrë që të vlerësojë sasinë e detyrimeve financiare, garancitë dhe besueshmërinë/aftësinë për të shlyer detyrimet financiare. Gjithashtu, 'Barrëdhënësi' jep pëlqimin që "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA të përdorë emrin dhe të dhënat identifikuase dhe financiare të 'Barrëdhënësit' që mbahen në Regjistrin e Kredive, për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë.

6.4. Sipas Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënavë personale", i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar 'Barrëdhënësi' në mënyrë të parevokueshme autorizon "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA të transferojë dhe të trajtojë të gjitha të dhënat personale dhe financiare të tij (më poshtë referuar si "Informacioni Konfidencial") me dëshira Shoqeria Mëmë e saj: "Intesa Sanpaolo" S.p.A, nëse dhe sa herë që kërkohet nga Shoqeria Mëmë: "Intesa Sanpaolo" S.p.A. 'Barrëdhënësi', duke kuptuar se të dhënat e tij personale dhe financiare do të trajtohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënavë personale, sekretin bankar dhe profesional, si dhe duke marrë në konsideratë gjithashtu se "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA dhe Shoqëria Mëmë e saj: "Intesa Sanpaolo" S.p.A kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për trajtimin e sigurt të të dhënavë të 'Barrëdhënësit', autorizon "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA, - që për qëllimet që përfshijnë: 1. vlerësimin e aplikimit të 'Kredimarrësit' për kredi; dhe/ose 2. vlerësimin e rrezikut të kredisë gjatë të gjithë afatit të marrëveshjes kontraktore të kredisë së 'Kredimarrësit' me "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA; dhe/ose 3. vlerësimin e besueshmërisë së 'Kredimarrësit' së bashku me palët e treta të lidhura me 'Kredimarrësit'; dhe/ose 4. mbikëqyrja e konsoliduar nga Shoqëria Mëmë: "Intesa Sanpaolo" S.p.A [duke përfshirë por pa u kufizuar tek qëllimet e konsolidimit të pozicioneve të mëposhtme: (a) kapitalin rregullator, (b) mjastueshmërinë e kapitalit, (c) ekspozimi i rrezikut, (d) pozicionet e hapura të këmbimeve valutore, (e) investimet në institucionet kapitale dhe jo kapitale]; dhe/ose 5. monitorimi dhe procesi i administrimit të rreziqeve të bankës dhe rrezikut të Grupit Bankar Intesa Sanpaolo, ose me konsolidimin e pozicioneve që parashikohen në Ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar - për të transferuar dhe trajtuar të gjitha të dhënat personale dhe financiare me dëshira Shoqëria Mëmë e saj: "Intesa Sanpaolo" S.p.A, nëse dhe sa herë që kërkohet nga Shoqeria Mëmë: "Intesa Sanpaolo" S.p.A. Në përputhje me sa më sipër, 'Barrëdhënësi' autorizon "Intesa Sanpaolo" S.p.A të ketë akses, të përdorë dhe të trajtojë të dhënat personale dhe financiare që zotëron "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA dhe/ose kjo e fundit merr në zotërim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu pranohet se i gjithë Informacioni Konfidencial do të mbrohet përpëra keqpërdorimit, dëmtimit, shkatërrimit, zhvlerësimit, humbjes dhe vjedhjes dhe "Intesa Sanpaolo" S.p.A nuk do të përdorë Informacionin Konfidencial për asnjë qëllim tjetër përvëçse për qëllimet që përcaktohen më sipër, si dhe nuk do t'i zbulohen, vihen në dispozicion, publikohen ose përhapen palëve të treta. "Intesa Sanpaolo" S.p.A do të sigurojë që vetëm personat përgjegjës (duke përfshirë Nën-kontraktorët dhe Filialët) të cilëve u zbulohet informacioni në

funksion të përbushjes së qëllimeve të parashikuara më sipër, do të kenë akses të Informacionit Konfidencial. Informacioni konfidencial mund të zbulohet deri në masën e parashikuar me ligj gjykatës, zyrës së prokurorisë dhe organeve të tjera kompetente që gjëzojnë këtë të drejtë në bazë të ligjit dhe rregulloreve të zbatueshme, një gjykatësi ose çdo autoriteti rregulator. "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA dhe Shoqeria Mëmë e saj: "Intesa Sanpaolo" S.p.A do të sigurojnë respektimin nga ana e Personelit të saj (duke përfshirë Nënkontraktorët dhe Filialat) të detyrimeve për konfidencialitetin e marrë përsipër.

6.5. Gjithashtu, përvèc sa përcaktohet në nenin 6.4, 'Barrëdhënesi' në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënavë personale", i ndryshuar (duke perfshirë ketu, por duke mos u kufizuar tek neni 6 pika I shkronja "a", nenin 8, si dhe te gjitha dispozitat e tjera ligjore dhe nën-ligjore të aplikueshme) dhe Ligjet Nr. 9662 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar jep pëlqimin dhe autorizon Bankën, të përpunojë, transferojë dhe të trajtojë të dhënat personale dhe financiare të tij, me dhe tek cdo subjekt i tretë, i cili kryen një ose disa shërbime në emër dhe përllogari të Bankës (duke perfshirë edhe nën-kontraktoret e tyre), me vendndodhje si brënda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës se Shqipërisë, të kontraktuar nga Banka sipas diskrecionit të Bankës, për qëllime të ushtrimit, monitorimit, vlerësimit dhe permirësimit të vazdueshëm, të aktivitetit të saj bankar dhe financiar; megjithatë duke parashikuar shprehimi shtetit se subjektit e tretë (duke perfshirë edhe nën-kontraktoret e tyre) do të janë gjithashtu përgjegjës dhe kanë detyrimin përruajtjen e fshehtësisë së të dhënavë personale dhe financiare te 'Barrëdhënesi'.

6.5.1 Banka garanton 'Barrëdhënesin' se përpunimi i të dhënavë do të menaxhohet nga staf teknik i zyrës përgjegjëse përruajtjën e të dhënavë personale dhe do të bëhet në përputhje me mënyrat e parashikuara nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënavë personale", i ndryshuar.

6.5.2 'Barrëdhënesi' nëpërmjet një kërkese me shkrim drejtuar Bankës, ka të drejtë (i) të marri në çdo kohë konfirmimin përruajtjën ose jo të të dhënavë personale të tij, informacion për qëllimin e përpunimit, përruajtjën e të dhënavë të përpunuara dhe përruajtjën e kategoritë e marrësve, të cilëve u përhapen të dhënat personale të 'Barrëdhënesit'; (ii) të njihet me përbajtjen dhe burimin e të dhënavë personale të përpunuara nga Banka; (iii) të kérkoj korrigjimin ose fshirjen e tyre kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat Ligjet Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrotjen e të Dhënavë Personale", i ndryshuar; (iv) të kundërshtojë, në çdo kohë, mbështetur në ligj, përpunimin e të dhënavë rreth tij. 'Barrëdhënesi' gëzon të drejtën e ankimit në rast se pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm në lidhje me të dhënat personale. Në rast se subjekti i të dhënavë ka bërë ankım, Banka nuk do të kryejë ndryshime në të dhënat e tij personale deri në dhënen e vendimit. 'Barrëdhënesi', të cilit i është shkaktuar një dëm, si rezultat i përpunimit të paligjshëm të të dhënavë personale, ka të drejtë t'i kérkoj kompensim Bankës përdëmin e shkaktuar.

6.6. Banka ka të drejtë që të cedojë tek personat e tretë, tërësisht ose pjesërisht, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga 'Kontrata e Kredisë', në bazë të gjykimit dhe vendimit të saj dhe pavarësisht nëse 'Kredimarrësi' ndodhet ose jo në kushtet e mospërbushjes së detyrimeve kontraktore. 'Barrëdhënesi' deklaron se kuption dhe pranon që Banka do të mund të disponojojë lirisht dhe të kaloj 'Kontratën e Kredisë' dhe rrjedhimisht dhe kete Kontrate, me ose pa shpërbilim, më vete ose si pjesë të një portofoli kredish, tek subjekte të tretë, sipas kuadrit ligjor të zbatueshëm.

Me nënshkrimin e kësaj Kontrate 'Barrëdhënesi' bie dakord të pranojë dhe ekzekutojë të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Kontrate kundrejt palës së tretë, në përputhje me Marrëveshjen e Cedimit apo Kalimit te Kontratës së Kredisë.

Për të bërë të mundur realizimin e këtij cedimi të drejtrash apo kalimi kontrate, sipas Ligjet Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënavë personale", i ndryshuar dhe Ligjet Nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, 'Barrëdhënesi' në mënyrë të parevokueshme autorizon Bankën t'i japë të dhënat personale dhe financiare të tij, të nevojshme përrpara, gjatë dhe pas lidhjes së Marrëveshjes së Cedimit (duke perfshirë edhe, por pa qënë i kufizuar në shitjen apo në një formë tjeter të disponimit të kontratës) kujtdo pale me të cilën Banka deshiron të hyjë në këtë marrëdhënie cedimi apo kalimi kontrate.

6.6.1 Përvèc rasteve të parashikuara shprehimi shtetit në ligj apo në aktet nën-ligjore të zbatueshme, 'Barrëdhënesi' nëpërmjet kësaj Kontrate, jep pëlqimin në mënyrë të parevokueshme se në rast mospërbushje te detyrimeve kontraktore sipas 'Kontratës së Kredisë' nga ana e 'Kredimarrësit', Banka në kuadër të rekuperimit të kredisë, pavarësisht nëse ka ndërmarrë ose jo veprimet proceduriale përmbarimore, do të ketë të drejtë të përrapë, transferojë dhe/ose të përpunojë të dhënat personale dhe

financiare të 'Barredhënesi', me cdo subjekt tjeter, në kuadër të vlerësimit paraprak apo realizimit të kalimit të Kontratës së Kredisë dhe rrjedhimisht dhe këtë Kontratë (nëpërmjet shitjes apo forma të tjera të disponimit, me ose pa shpërblim), më vete ose si pjesë të një portofoli kredish, tek subjekte të tretë, sipas kuadrit ligjor të zbatueshëm.


Neni 7– Legjislacioni qe zbatohet

Kjo Marrëveshje Siguruese është objekt dhe është hartuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe çdo mosmarrëveshje, konflikt ose pretendim i lindur ose i lidhur me këtë Marrëveshje Siguruese do të shqyrtohet dhe zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë.

Kjo Marrëveshje Siguruese u hartua në 3(tre) kopje të njëjtë e të barazvlefshme në gjuhën shqipe. Secila nga palët mban nga një kopje; dhe një kopje e Marrëveshjes Siguruese ruhet në Zyrën Notoriale. Interpretimi i kushteve kontraktore do të bëhet në perputhje me legjislacionin e aplikueshëm dhe qëllimin e palëve për të lidhur këtë Marrëveshje Siguruese.

Unë Noterja, ua lexova me zë të lartë palëve tekstin e kësaj Marreveshje Siguruese dhe i njoja palët me efektet ligjore të saj, ato më deklaruan se e kuptojnë atë, konstatova se palet e gjejnë Marreveshjen Siguruese në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe te plotë, dhe Unë Noterja i vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjit.

BARRËMARRËSI



BARRËDHËNËSI

Mihal Hudhra


Vojsava Hudhra

NOTERE

Mihal V. Hudhra







REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L82002021J	
2. Data e Regjistrimit	02/08/2018	
3. Emri i Subjektit	HEC KOTKA	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	27/07/2018	
6. Kohëzgjatja	Nga: 27/07/2018	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Brigada VIII, Ndertesa 23, Hyrja 16, Ap.20, kodi postar 1019	
8. Kapitali	100.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00	
9. Objekti i aktivitetit	Ndertimi i hidrocentralit Kotka ne lumin e Tomorrices. Prodhim, transmetim dhe shperndarje te energjise elektrike, nepermjet ndertimit te hidrocentraleve. Ndertim, depozitim, shfrytezim i burimeve ujore dhe natyrore me qellim prodhimin e energjise. Krijimin e linjave te prodhimit, te njesive te vogla dhe te medha per prodhimin dhe tregtimin e energjise elektrike se prodhuar nga burime natyrore dhe alternative.	
10. Administratori/ët	Mihal Hudhra	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 21/09/2018	Deri: 20/09/2023
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	Mihal Hudhra	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 100.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00
- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)	
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: HEC KOTKA Telefon: 0693346209 Kutia Postare: 1019 1019
15. Statusi:	Aktiv

Datë: 16/07/2019



Emri, Mbiemri, Nënshtkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L71422032S	
2. Data e Regjistrimit	22/02/2017	
3. Emri i Subjektit	TOER ENERGY	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	21/02/2017	
6. Kohëzgjatja	Nga: 21/02/2017	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga Reshi Çollaku, Pallati Aurora Konstruksion, mbrapa Gjykates se Larte, Pallati Nr. 26, Ap. 6, Kat. 2	
8. Kapitali	100.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00	
9. Objekti i aktivitetit	Shoqeria do te ushtroje aktivitet privat ne fushen e sherbimeve kryesisht: Projektim, ndertim dhe operim i H.E.C.-ve, ku perfshihet ndertimi, venia ne pune, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shperndarja, eksportimi dhe shitja e enrgjise elektrike. Shoqeria mund te kryeje edhe veprimtari te tjera ndihmese te cilat mbeshtesin arritjen e qellimit te saj kryesor ne perputhje me legjisacionin ne fuqi.	
10. Administratori/ët	Mihal Hudhra	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 21/02/2017	Deri: 21/02/2022
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	Vojxava Hudhra	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 50.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00	



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

<p>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</p>	
13. Ortakët	Mihal Hudhra
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 50.000,00
13.2 Numri i pjesëve	Natyre:
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	1.00
	50,00
- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)	
14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Berat Çorovode COROVODE Fshati Dobrenje, Bashkia Skrapar
15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: TOER ENERGY E-Mail: info@elva.al Telefon: 0682043181
16. Statusi:	Aktiv

Datë: 16/07/2019

Emri, Mbiemri, Nënhkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI AKSIONARE”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	K12809402J		
2. Data e Regjistrimit	09/04/2001		
3. Emri i Subjektit	ELVA 2001 SH A		
4. Forma ligjore	Shoqëri Aksionare		
5. Data e themelimit	13/02/2001		
6. Kohëzgjatja	Nga: 13/02/2001 Deri:		
7. Zyra qëndrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Ndraq NDROQ Lagija e Re, Ndertese 2 kateshe brenda Parkut te Rezervuarve Bitum, Mazut, Kati 1		
8. Kapitali	100.000.000,000		
9. Vlera e kapitalit të shlyer:	100000000.0000		
10. Numri i aksioneve:	5.000,000		
10.1 Vlera nominale:	20.000,000		
11. Kategoritë e aksioneve të shoqërisë	të zakonshme	me përparësi	me të drejtë vote
11.1 Numri për secilën kategori			pa të drejtë vote
12. Objekti i aktivitetit:	Import eksporth-transport,tregtim me shumice i naftes brut,gazit natyror,gazit te lengshem,i nenprodukteve te perpunuara te naftes si benzine,mazut,bitum,koks nafte,squfur,vajra lubrifikant etj.Studime dhe asistence teknike,kekrimore dhe shkencore ne fushen e nxjerjes dhe perpunimit te naftes dhe gazit .Importe-eksport te lendeve te		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

<p>para ,makineri produkte te fushes se industrie mekanike,elektrike,ndertimit etj.Investitor privat ne fushen e ndertimeve publike,shteterore civile etj. Veprimtari ne fushen e zbatimit te punimeve te ndertimit, ndertime te çdo lloji dhe ne te gjitha fushat, ndertime civile, industriale, sociale si dhe ndertimet e impianteve te trajtimit te plehrave dhe veprimtari ne fushen e energjise, ndertim, prodhim dhe tregetim i energjisë nga burime te rinovueshme. Pjesemarrje ne tendera publike per realizimin e punimeve te ndertimit si kontraktor kryesor dhe Joint Venture. Prodhim e tregetim me shumice e pakice dhe import eksport te materialeve te ndryshme te ndertimit. Pastrim ambienti.Ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne menyre qe te realizohet qellimi i mesiperm shoqeria mund: te marre pjesë ne çdo entitet tjeter ligjor i cili ushtron veprimtari te njejtë ose te perafert me shoqeri ne Shqiperi dhe jashte saj; te bashkeoperoje, bleje dhe shkrihet me kompani te tjera, me çdo individe apo entitet tjeter ligjor; te krijoje dege ose zyra brenda Shqiperise ose jashte saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar.Shoqeria kryen çdo lloj aktiviteti qe lidhet me objektin e saj te veprimtarise dhe per ta favorizuar ate.</p>	
13. Sistemi i administritimit	<input type="checkbox"/> me një nivel <input checked="" type="checkbox"/> me dy nivele
14. Administratori/ët	Mihal Hudhra
14.1 Afati i emërimit	Nga: 09/06/2011 Deri: 09/06/2020
15. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.	
15.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka).	
16. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës (<i>plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele</i>)	Leonard Lushaj
16.1 Kryetar/anëtar	Anetar
16.2 Afati i emërimit	Nga: 04/11/2016 Deri: 04/11/2019
17. Anëtar i Pavarur	Po
17.1 Përfaqesues i Punëmarrësve	Jo
17.2 Kushtet e pjesëmarrjes	
18. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.	
19. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës (<i>plotësohet nëse është Sh.a me dy</i>	Eltion Mihali






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

<i>nivele)</i>	Anetar	
19.1 Kryetar/anëtar	Nga: 09/06/2011	Deri: 09/06/2020
19.2 Afati i emëritimit		
20. Anëtar i Pavarur	Po	
20.1 Përfaqesues i Punëmarrësve	Jo	
20.2 Kushtet e pjesëmarrijes		
21. Procedura e emëritimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		
22. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës (plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele)	Luan Basha	
22.1 Kryetar/anëtar	Anetar	
22.2 Afati i emëritimit	Nga: 04/11/2016	Deri: 04/11/2019
23. Anëtar i Pavarur	Po	
23.1 Përfaqesues i Punëmarrësve	Jo	
23.2 Kushtet e pjesëmarrijes		
24. Procedura e emëritimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		
25. Eksperti/ët Kontabël i Autorizuar	Artan Xhiani	
25.1 Afati i emëritimit	Nga: 15/08/2014	Deri: 30/06/2015
26. Aksionarët	Vojsava Hudhra	
26.1 Numri i Aksioneve	Me te drejte vote: 2500.0000 Pa te drejte vote:	
	50,000	
26.2 Përqindja e pjesëmarrijes		
27. Aksionarët	Mihal Hudhra	
27.1 Numri i Aksioneve	Me te drejte vote: 2500.0000 Pa te drejte vote:	
	50,000	
27.2 Përqindja e pjesëmarrijes		
28. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Fier Fier FIER Autobot me targa FR 2237 C Tirane Ndraq NDROQ Autobot ABR 062 Tirane Ndraq NDROQ Koke terheqese me targa AA 263 OH Tirane Tirane TIRANE Kamion (autobot) MAN me targa AA 615 FT. Tirane Ndraq NDROQ Autobot ABR 018	





REPUBLIKA E SHQIPÉRISÉ

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISÉ
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

Tirane Ndraq NDROQ Koke terheqese me targe AA 746 OE
 Tirane Ndraq NDROQ Autobot ABR 389
 Tirane Ndraq NDROQ Autobot ABR 019
 Tirane Ndraq NDROQ Mjet tip Kamion deri 3.5 ton Tyota Hilux me targe AA 546 RD
 Tirane Ndraq NDROQ Koke Terheqese AA524EG
 Tirane Ndraq NDROQ Koke terheqese me targe AA 745 OE
 Tirane Ndraq NDROQ Koke Terheqese AA 523 EG
 Tirane Tirane TIRANE Rruga Reshit Çollaku, Pallati Aurora Konstruksion, mbrapa Gjykates se Larte.
 Tirane Ndraq NDROQ Kamion autobot Man me targa AA 604 JX
 Tirane Tirane TIRANE Mjeti tip Nisan Navara (ATP), me targe AA561UO
 Tirane Tirane TIRANE Kamion Mercedes Benz me targe AA 685 AM.
 Tirane Ndraq NDROQ Kamion Cisterne Renault me targa AA 830 LT
 Tirane Ndraq NDROQ Autobot me targe ABR 887
 Tirane Ndraq NDROQ Autobot ABR063
 Berat Zhepe DOBRENJE Hec Mivas, fshati Bobrenje, Bashkia Skrapar
 Tirane Tirane TIRANE Mjeti gjysem rimorkjo.(autobot) "aurepa" me targa AAR 288



29. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: ELVA 2001 SH A E-Mail: info@elva.al Telefon: 0682043181
30. Statusi:	Aktiv

Lista e Dokumenteve:

Regjistrimi Fillestar: CN-051474-09-07

HISTORIKU I REGJISTRIMIT

Data e regjistrimit	Ndryshimi i te dhenave te regjistruara
1. 15/03/2001	Numri i Vendimit:25441, Gjykata:Tirane Data e regjistrimit-15.03.2001, Emri i subjektit-ELVA 2001, Forma ligjore-SHPK, Data






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

		<p>themelimit-13.02.2001, Selia-LAga "1 Maj",nr.8,Fier, Kohezgjatja-Mbi 10 vjet, Kapitali-100 000 leke, Objekti-Transport e tregtim m e pakice te nenprodukteve te naftes si bitum,solar,mazut,lubrifikante etj. Perfaqesuesi ligjor-Luan Hasanbasha, Ortak-Luan Hasanbasha dhe Vojsava Hudhra, Lista e Dokumenteve: <u>R-Mix-El-07.12.07 (2).pdf</u></p>
2. 21/02/200 2		<p>Numri i Vendimit:25441/1, Gjykata:Tirane Me vendim eshte vodosur; miratimi i kerkeses se ortakut Luan Hasanbasha per tu larguar teresisht nga shoqeria nepermjet shitjes se kuotave te veta, ortakut te ri z.Mihal Hudhra.Pranimi e doreheqjes se Z.Luan Hasanbasha si administrator i shoqerise dhe emerin e z.Mihal Hudhra.Shtimin e objektit me import-eksport te prodhimeve e artikujve te ndryshem, ushqimor,industrial,paisje e makineri te fushes mekanike,te ndertimit,produkteve kimike,shitje te tyre me pakise e shumice. Lista e Dokumenteve: <u>R-Mix-El-07.12.07 (2).pdf</u></p>
3. 31/01/200 6		<p>Numri i Vendimit:25441/2, Gjykata:Tirane Me vendim eshte vodosur;shderimi shoqerise " ELVA 2001" shpk nga shoqeri me perjegjesi te kufizuar ne nje shoqeri anonime.Rritja e kapitalit te shoqerise per krijimin e shoqerise anonime.Emerimin e z.Kastriot Haxhaj,ekspert kontabel i autorizuar per kryerjen e raportit te ekspertimit. Lista e Dokumenteve: <u>R-Mix-El-07.12.07 (2).pdf</u></p>
4. 06/02/200 6		<p>Numri i Vendimit:25441/3, Gjykata:Tirane Depozitim e vendimit nr.1,date 29.12.2005 te Asamblese se Aksionere te shoqerise sipas se ciles eshte vodosur; Miratimin e raportit te ekspertit kontabel.Rritja e kapitalit te shoqerise nga 100 000 leke ne 5 000 000 leke duke ruajtur te pa ndryshuar zoterimin e aksioneve si me poshte;Mihal Hudhra zoterues i 50% te kapitalit me vlere 2 500 000 leke dhe Vojsava Hudhra zoterues e 50 % te kapitalit me vlere 2 500 000 leke.Miratimin e bilanceve financiare te dy vitave te fundit.Shnderimin e shoqerise nga nje shoqeri me perjegjesi te kufizuar ne nje shoqeri anonime.Miratimin e statutit dhe aktit te ri te themelimit. Zgjedhjen e Keshillit Mbikqyres te perbere nga;1.Vojsava Hudhra,2.Kastriot Gishti dhe 3.Eltion Hudhra.Miratimin e objektit te ri Import eksport ,transport,tregtim me shumice i naftes brut,gazit natyror,gazit te lengshem,i nenprodukteve te perpunuara te naftes si benzine,benzine avinesh,gazoil,vajgur ndriques,vajguri avionash,aromatik,solevent,wite spirit,lende djegese solar, mazut,bitum,koks nafte,squfur,vajra lubrifikant et.Studime dhe asistence teknike,kekrimore dhe shkencore ne fushen e nxjerjes dhe perpunimit te naftes dhe gazit,analiza laboratorike te te gjitha</p>





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	<p>nenprodukteve te naftes. Importe-eksport te lendeve te para ,makineri produkte te fushes se industrise mekanike,elektrike,ndertimit,kimike ushqimore etj.Investitor privat ne fushen e ndertimeve publike,shteterore civile etj.Selia eshte Fier,Lagija "1 Maji".Depozitimin e vendimit nr.1 te Keshillit Mbikqyres sipas te cilit eshte vodosur;Emerimi i z.Mihal Hudhra ne detyrene Drejtorit te Pergjithshem.Zgjedha e znj.Vjosa Hudhra kryetare e Keshillit Mbikqyres.</p> <p><u>Lista e Dokumenteve:</u> <u>R-Mix-El-07.12.07 (2).pdf</u></p>
Sot më datë 16 Korrik 2019, në selinë e shoqërisë, “ELVA 2001” sh.a., u zhvillua mbledhja e Asamblesë së Shoqërisë me objekt: miratimin e praktikës per marrjen e kredise per ndertimin e Hec Mivas ne banken Intesa Sanpaolo Bank-Albania.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin;

Z. Mihal HUDHRA, - Aksioner i shoqërisë me 50% të pjesemarrjes ose 2500 aksione.
Znj. Vojsava HUDHRA- Aksioner i shoqerise me 50% te pjesemarrjes ose 2500 aksione.

Asambleja e ortakeve, ka rene dakort dhe ka miratuar unanimisht sa me poshte vijon:

- Marrjen e një kredie me Intesa Sanpaolo Bank - Albania sha.nevlerën prej LEKE 125,000,000 (njëqind e njezete e pese milion), me qellim ndertimin e objektit Hec Mivas “ me adresë Ujembledhesi i Lumit Tomorrice , bashkia Gramsh dhe Bashkia Skrapar;
- Te miratojne vendosjen e hipotekës se rradhës se pare ne favor te Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a mbi pasurine e paluajtshme ne progresi te shoqerise me qellim garantimin e detyrimeve qe rrjedhin nga kredia e lartpërmendor, perkatesisht;

“truall” pasuri kjo me sipërfaqe totale 7.030 m², nga te cilat truall me sipërfaqe 5.000 m² dhe ndertese me sipërfaqe 915 m² e ndodhet ne Tirane, Lagjia e Re. Pasuria me nr. Pasurie 353/2; Vol.1; Fq. 188 ndodhet e regjistruar ne Zonen Kadastrale Nr. 2367.

- Te miratojnë vendosjen e hipotekës se rradhës se pare mbi sendin e ardhshëm ne favor te Bankesme qellim garantimin e detyrimeve qe rrjedhin nga kredia e lartpërmendor, perkatesisht mbi “lëresinë e aseteve te paluajtshme si dbe te drejtat dhe pretendimet e lidhura me to qe janë krijuar apo do te krijoben bazuar Lejen e Ndertimit me nr. 277/5 Prot date 25.03.2019 leshuar nga Keshilli Kombetar i Territorit dbe Kontraten per Ndertimin, shfrytëzimin dbe administrimin e Hidrocentralit “MIVAS” me kapacitet prodhues 1.940 MW, ne pellgun sjëmbledhës te Lumit te Tomorrit, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan lidhur ndërmjet Ministrise se Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Shoqerise “Elva 2001” Shpk ne rilësinë e Mbajtësit te Miratimit”

Te miratojnë vendosjen e barrës siguruese te radhës se pare ne favor te Bankes me qellim garantimin e detyrimeve qe rrjedhin nga kredia e lartpërmendor mbi “linjat e prodhimit, makinerite, pajisjet, impiantet si dbe çdo pasuri tjeter te luajtshme te tashme dbe te ardhshme (asjet e Koncessionit)”;

- Te miratojnë vendosjen e barrës siguruese te radhës se pare ne favor te Bankes me qellim garantimin e detyrimeve qe rrjedhin nga kredia e lartpërmendor mbi “Nogarite rrjedhese te futura aktualisht apo qe mund te jelen ne ardhmen prane Bankes si dbe te ardhurat e arketueshme te tashme apo te ardhshme si dbe te gjitha te drejtat dhe pretendimet mbi to”;



- Te miratojnë vendosjen e barrës siguruese te radhës se pare ne favor te Banks me qellim garantimin e detyrimeve qe rrjedhin nga kredia e lartpermendor mbi "kuotat e shoqërisë" si dhe regjistrimin e Marrëveshjes Siguruese përkatëse pranë QKB;
- Te miratojnë rinovimin vjetor te te gjitha linjave ekzistuese te kredise prane Banks ne përputhje me kushtet e rena dakord me Banken;
- Te miratoje autorizimin e Z. Mihal Hudhra, ne cilësinë e Administratorit te shoqeriseme qellim nenshkrimin ne emer dhe per llogari te shoqerise "ELVA-2001 sha" te kontratesse kredise bankare, Kontratesse Hipotekimit, Kontrates se Hipotekimit mbi sendin e ardhshëm, Marreveshjeve siguruese per secilin nga garancitë e ofruara, amendamentet e linjave ekzistuese si dhe cdo lloj akti tjeter , dhe pse te papermendor shprehimisht ne kete vendim por te nevojshem per te realizuar sa me lart permendor (perfitim e kesaj kredie); Z. Hudhra , gjithashtu ka te drejte te nenshkruaje cdo dokument tjeter qe gjykohet i nevojshem nga palet si rrjedhoje e ne funksion te bashkepunimit.
- Te miratojnë regjistrimin e këtij Vendimi ne librin e vendimeve te Shoqerise.

Shoqeria eshte ne dijeni te efekteve qe keto veprime juridike prodhojne ne emer dhe per llogari te saj dhe pasi i deklaron te drejta dhe te ligjshme te lidhura ne funksion te nje administratori sa me te mire te shoqerise dhe kryerjes se objektit te veprimitarise se saj, perfundimisht miraton dhe pranon te gjitha detyrimet e lindura ne emer dhe per llogari te saj kundrejt Intesa Sanpaolo Bank – Albania.

SHOQERISE "ELVA 2001 sha

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Mihal Hudhra
(Firma)

Mihal Hudhra

Hudra

Vojsava Hudhra
(Firma)

Vojsava Hudhra

fep





REPUBLIKA E SHQIPERISE
DEGA VENDORE E E NOTEREVE TIRANE
NOTERE PUBLIKE ILDA V. SHARRA
Nr. 1265 Rep.



VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me date 17 Korrik 2019 (dymije e nëntëmbëdhjetë), perpara meje Noteres Publike Ilda SHARRA, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, me seli ne Rrugen "Sami Frasherri", P.20, Shk.1, kati 1, u paraqiten personalisht shtetasit;

- **Mihal Hudhra** atesia Miti, i datelindjes 07.11.1953, lindur ne Lagja e Re Vlore e banues ne Tirane ne adresen Rr : »Brigada VIII » pallati Tekno-Projekt, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar, njohur prej meje noteres me Leternjoftimin (ID) Nr.034211884/ Nr.Personal F31107012C leshuar nga MB date 07.05.2019 ;
- **Vojsava Hudhra**, atesia Kasem, e datelindjes 02.10.1953, lindur ne Fier e banuese ne Tirane ne adresen Rruga "Brigada VIII" pallati Teknjo Projekt , shtetase shqiptar, madhore, me zotesi juridike dhe per te vepruar, njohur prej meje noteres me Leternjoftmin(ID) Nr. 027225299/Nr.Personal F36002014A leshuar nga MB date 04.08.2009; ne cilesine e aksionarëve themelues te Shoqerise"ELVA 2001" SHA me seli ne Tirane ne adresen Ndraq, Lagija e Re, Ndertese 2 kateshe, brenda Parkut te Rezervuarve Bitum, Mazut, Kati 1, rregjistruar si person juridik date 09.04.2001, me NIPT K12809402J;

Te cilet me vullnetin e tyre të lire, të plete dhe të sinqerte me deklaruan se nenshkrimi i vene ne Vendimin e Asamblese se Aksionarëve Shoqerise"ELVA 2001" SHA date 16.07.2019, eshte i tyre.

Une Noterja vertetoj irregullsine dhe bazueshmerine e redaktimit ne ligj të ketij akti si dhe autenticitetin e nenshkrimit, me cilesine qe me njeh neni 128 i Ligjit nr. 110 date 20.12.2018 "Per Noterine " ne Republiken e Shqiperise.

NOTE

Ilda V. Sharra



VENDIM

I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE "HEC KOTKA" SHPK.

Sot më datë 16 Korrik 2019, në selinë e shoqërisë, "HEC KOTKA" sh.p.k., u zhvillua mbledhja e Asamblesë së Shoqërisë me objekt: miratimin e vendosjes se barres se sigurise per kuotat e shoqerise, ne favor te Bankes Intesa Sanpaolo Bank-Albania, per kredine nevlerën prej LEKE 125,000,000 (njëqind e njezete e pese milion), marre nga shoqeria Elva 2001 sha, me qellim ndertimin e objektit Hec Mivas " me adrese Ujembledhesi i Lumin Tomorrice, bashkia Gramsh dhe Bashkia Skrapar.

I pranishëm në këtë mbledhje ishte :

Z. Mihal HUDHRA, - ortak i vetem i shoqërisë me 100% .

Ortaku i vetem ka rene dakort dhe ka miratuar unanimisht sa me poshte vijon.

Te miratojnë vendosjen e barrës siguruese te radhës se pare ne favor te Bankes me qellim garantimin e detyrimeve qe rrjedhin nga kredita e lartpërmendur mbi "kuotat e shoqërisë" si dhe regjistrimin e Marrëveshjes Siguruese përkatëse pranë QKB;

Shoqeria eshte ne dijeni te efekteve qe keto veprime juridike prodhojne ne emer dhe per llogari te saj dhe pasi i deklaron te drejta dhe te ligjshme te lidhura ne funksion te nje administrimi sa me te mire te shoqerise dhe kryerjes se objektit te veprimtarise se saj, perfundimisht miraton dhe pranon te gjitha detyrimet e lindura ne emer dhe per llogari te saj kundrejt Intesa Sanpaolo Bank – Albania.

ORTAKU SHOQERISE

Mihal Hudhra



NIPT: LB20026213
HEC KOTKA
SH.p.k.
TIRANE - ALBANIA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DEGA VENDORE E E NOTEREVE TIRANE
NOTERE PUBLIKE ILDA V. SHARRA
Nr. 1264 Rep.



VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me date **17 Korrik 2019** (dymije e nëntëmbëdhjetë), perpara meje Noteres Publike Ilida SHARRA, anetare e Dhomës se Notereve Tirane, me seli ne Rrugën "Sami Frasherri", P.20, Shk.1, kati 1, u paraqit personalisht shtetas;


- **Mihal Hudhra** atesia Miti, i datelindjes 07.11.1953, lindur ne Lagja e Re Vlore e banues ne Tirane ne adresen Rr : »Brigada VIII » pallati Tekno-Projekt,shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar,njohur prej meje noteres me Leternjoftimin (ID) Nr.034211884/ Nr. Personal F31107012C leshuar nga MB date 07.05.2019 ; ne cilesine e ortakut themelues te Shoqerise"HEC KOTKA" shpk me seli ne Tirane ne adresen Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Brigada VIII, Ndertesa 23, Hyrja 16, Ap.20, kodi postar 1019, rregjistruar si person juridik date 27.07.2018, me NIPT L82002021J;

I cili me vullnetin e tij te lire, te plete dhe te sinqerte me deklaroi se nenshkrimi i vene ne Vendimin e Ortakut te Vetem te Shoqerise"HEC KOTKA" shpk date 16.07.2019, eshte i tij.

Une Noterja vertetoj irregullsine dhe bazueshmerine e redaktimit ne ligj te ketij akti si dhe autenticitetin e nenshkrimit, me cilesine qe me njeh neni 128 i Ligjit nr. 110 date 20.12.2018 "Per Noterine " ne Republiken e Shqiperise.

NOTE RE

Ilda V. Sharr



VENDIM

I ASAMBLESË SË ORTAKEVE TE SHOQERISE "TOER ENERGY" SHPK.

- Sot më datë 16 Korrik 2019, në selinë e shoqërisë, "Toer Energy" sh.p.k., u zhvillua mbledhja e Asamblesë së Shoqërisë me objekt: miratimin e vendosjes se barres se sigurise per kuotat e shoqerise, ne favor te Bankes Intesa Sanpaolo Bank-Albania, per kredine nevlerën prej LEKE 125,000,000 (njëqind e njezete e pese milion), marre nga shoqeria Elva 2001 sha, me qellim ndertimin e objektit Hec Mivas " me adrese Ujembledhesi i Lumin Tomorice, bashkia Gramsh dhe Bashkia Skrapar.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin ;

Z. Mihal HUDHRA, - Aksioner i shoqërisë me 50% .

Znj. Vojsava HUDHRA- Aksioner i shoqerise me 50% .

Asambleja e ortakeve , ka rene dakort dhe ka miratuar unanimisht sa me poshte vijon:

Te miratojnë vendosjen e barrës siguruese te radhës se pare ne favor te Bankes me qellim garantimin e detyrimeve qe rrjedhin nga kredita e lartpërmendur mbi "kuotat e shoqërisë" si dhe regjistrimin e Marrëveshjes Siguruese përkatëse pranë QKB;

Shoqeria eshte ne dijeni te efekteve qe keto veprime juridike prodhojnë ne emer dhe per llogari te saj dhe pasi i deklaron te drejta dhe te ligjshme te lidhura ne funksion te nje administrimi sa me te mire te shoqerise dhe kryerjes se objektit te veprimtarise se saj, perfundimisht miraton dhe pranon te gjitha detyrimet e lindura ne emer dhe per llogari te saj kundrejt Intesa Sanpaolo Bank – Albania.

ORTAKET E SHOQERISE

Mihal Hudhra

(Firma)

Mihal Hudhra


Vojsava Hudhra

(Firma)







REPUBLIKA E SHQIPERISE
DEGA VENDORE E E NOTEREVE TIRANE
NOTERE PUBLIKE ILDA V. SHARRA
Nr. 1263 Rep .



VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me date 17 Korrik 2019 (dymije e nëntëmbëdhjetë), perpara meje Noteres Publike Ilida SHARRA, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, me seli ne Rrugën "Sami Frasheri", P.20, Shk.1, kati 1, u paraqiten personalisht shtetasit;

- **Mihal Hudhra** atesia Miti, i datelindjes 07.11.1953, lindur ne Lagja e Re Vlore e banues ne Tirane ne adresen Rr : »Brigada VIII » pallati Tekno-Projekt,shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar,njohur prej meje noteres me Leternjoftimin (ID) Nr.034211884/ Nr.Personal F31107012C leshuar nga MB date 07.05.2019 ;
- **Vojsava Hudhra**, atesia Kasem, e datelindjes 02.10.1953, lindur ne Fier e banuese ne Tirane ne adresen Rruga "Brigada VIII" pallati Tekno Projekt , shtetase shqiptar, madhore, me zotesi juridike dhe per te vepruar, njohur prej meje noteres me Leternjoftmin(ID) Nr. 027225299/Nr.Personal F36002014A leshuar nga MB date 04.08.2009; ne cilesine e ortakeve themelues te Shoqerise"TOER ENERGY" shpk me seli ne Tirane ne adresen Rruga "Reshit Çollaku", Pallati Aurora Konstruksion, mbrapa Gjykates se Larte, Pallati Nr. 26, Ap. 6, Kati 2, rregjistruar si person juridik date 22.02.2017, me NIPT L71422032S;

Te cilet me vullnetin e tyre të lire, të plote dhe të sinqerte me deklaruan se nenshkrimi i vene ne Vendimin e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise""TOER ENERGY" shpk date 16.07.2019, eshte i tyre.

Une Noterja vertetoj irregullsine dhe bazueshmerine e redaktimit ne ligj të ketij akti si dhe autenticitetin e nenshkrimit, me cilesine qe me njeh neni 128 i Ligjit nr. 110 date 20.12.2018 "Per Noterine " ne Republiken e Shqiperise.

NOTE RE

Ildi V. Sharr





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBETARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NR. 1267 REP.

NR. 563 KOL.

KONTRATË KREDIE BANKARE

Sot më datë 18-07-2019, përpara meje, Noterës Flora V. Sharrq, anëtare e Dhomës se Noterisë Tirane, me Zyre Notieriale ne Tirana, '5 frashëri paraqiten palët si më poshtë:

KREDIDHËNËSI: "INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA" SHA, me Numer Unik te Identifikimit (NIPT) J81817006P, regjistruar me Vendim nr. 19460, datë 19.05.1998, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me seli në Rr. Ismail Qemali, nr. 27, Tiranë, Shqipëri, e përsaqësuar prej **Z. Olsi Kota**, shtetas shqiptar, lindur më 04.02.1984 në Tiranë, me Letërmjofim Nr. I40204028V dhe nga Zj. **Jonida Cule**, shtetase shqiptare, lindur ne Tiranë, me 30.05.1983, identifikuar me nr. personal I35530152N, ne cilesine e perfaqesuesve te Bankes (Këtu e më poshtë referuar edhe si "Banka");

KREDIMARRËS: "ELVA 2001" SHA, me Numer Unik te Identifikimit (NIPT) K12809402J, regjistruar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane, me Vendimin nr. 25441, date 15.03.2003, ndryshuar me Vendimin nr. 25441/3 date 06.02.2006, me seli ne Lagjja e Re, Ndertese 2 kateshe brenda Parkut te Rezervuarve Bitum, Mazut, Kati 1, Ndroq, Tirane, perfaqesuar nga z. Mihal Hudhra, shtetas shqiptar, lindur ne Vlore, me 07.11.1953, mbajtes i Leternjofitimit, me nr. personal F31107012C, ne cilesine e administratorit te shoqerise, sipas Vendimit te Keshillit Mbikqyres te dates 16/02.2019 dhe Vendimi i Asamblese se Aksionareve te datës 16/02.2019 (Këtu e më poshtë referuar si "**Kredimarrësi**")

me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilëve, unë njerja jam e sigurt. Ato më deklaruan se dëshirojnë të lidhin këtë Kontratë Kredie Bankare me përbajtjen si më poshtë vijon:

NENI 1 - PERKUFEZIME

1.01 Kudo, ku përdoren në këtë Kontratë (duke përfshirë edhe Shtojcat dhe Amendamentet/Ndryshimet),
dhe vetëm nëse shprehimi i parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet
e mëposhtme:

"Kontratë" nënkupton këtë Kontratë Kredie Bankare, si dhe çdo shtesë, ndryshim, ose modifikim të kësaj Kontrate.

"Principal" nénkuption shumën e kryegjësë së kredisë, që Banka do të lëvrojë në favor të Kredimarrësit, me plotësimin e kushtevë të lëvrimit ose sipas përcaktimit të kësaj Kontratë.

"Diskursimi" nënkuption mënyrën (duke përfshirë këtu kushtet, afatet, vendin, dhe/ose llogarinë barkerë etj) e lëvrimit të ‘Principalit’, në tërësi apo me këste, sikundër përcaktohet në nenin 2 “Kushtet e Posacme” dhe në klausolat e tjera të kësaj Kontrate.

"Periudha e Disbursimit" nënkupton periudhën përgjatë se cilës Banka do te lëvrojë ne favor te Kredimarresit me plotësimin e kushteve të lëvrimit ose sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate. Kjo periodhe fillon ne datën e nënshkrimit te kësaj Kontrate dhe përfundon ne datën e përcaktuar shprehimi i Nenin 2 "Kushtet e Posacme" te kësaj Kontrate.

“Qëllimi i Kredisë” nënkuption qëllimin për të cilin do të përdoret ‘*Principali*’ nga ana e Kredimarrësit.

"Komisioni i Angazhimit" nënkuption vlerën monetare të shprehur në përqindje, që paguhet nga Kredimarrësi në favor të Bankës për atë pjesë të shumës së '*Principalit*' e cila është e palëvruar. Komisioni i Angazhimit aplikohet me bazë vjetore dhe metoda e illogaritjes është Aktual/360 (numri i ditëve/treqind e gjashtëdhjetë). Komisioni paguhet cdo muaj, duke filluar pagimin e këstuit të parë 30 (tridhjetë) ditë pas ditës së fillimit të lëvrimit të shumave të '*Principalit*', në përputhje me shumat dhe datat e kësteve, sic përcaktohen në Skedulin e Pagimit të Komisionit të Angazhimit, që Bajka i jep Kredimarrësit në datat e lëvrimit të shumave të '*Principalit*' të kredisë.

"Norma Vjetore e Interesit" nënkupton, normën vjetore më të lartë ndërmjet: (i) Normës Minimale të Interesit, dhe (ii) Norma Bazë e Interesit + Marzhi.

Pavarësishët nga përcaktimet e mësipërme, Norma Vjetore e Interesit mund të rritet me një kuotë tjetër fikse, nëse parashikohet shprehimisht nga palët në këtë Kontratë për rastet e mospërmbushjes së Detyrimeve Specifike të Kredimarrësit.

"Norma Bazë e Interesit" nënkupton kuotën e ndryshueshme (sipas indeksit dhe afatit specifik të indeksit), pjesë përbërëse të 'Normës Vjetore të Interesit', dhe që përcaktohet shprehimisht në nenin 2 "Kushtet e Posaçme" të kësaj Kontrate.

Fillimi i Norma Bazë e Interesit do të jetë e barabartë me indeksin përkatës në ditën e lëvrimit të shumës së 'Principalit' (nëse 'Disbursimi' kryhet me një këst të vetëm), ose në ditën e lëvrimit të këstit të parë (nëse 'Disbursimi' kryhet me këste).

Norma Bazë e Interesit ndryshon automatikisht çdo vit, dhe do të jetë e barabartë me indeksin përkatës, sipas referencës në datën respektive të ndryshimit. E njëjtë mënyrë përllogaritje do të përdoret cdo vit deri në vitin e fundit të kohëzgjatjes së kredisë.

Norma Bazë e Interesit, sipas rastit nëse shifra e dytë pas presjes dhjetore do të rezultojë 5 ose më e madhe se 5, do të rrumbullakoset në mënyrë rritëse, në të kundërt nuk do të pësojë asnjë ndryshim, duke parashikuar që Norma Bazë e Interesit do të merret me tre shifra dhjetore. [Shembull ilustrues: nëse Norma Bazë e Interesit është 0.879...%, Norma Bazë e Interesit do të përllogaritet 0.880 % dhe nëse Norma Bazë e Interesit është 1.137...% do të përllogaritet 1.137%].

"Indeksi i Normës Bazë të Interesit" nënkupton një nga llojet e përkufizuara më poshtë, të cilin palët e përzgjedhin dhe përfshijnë në nenin 2 "Kushtet e Posaçme" të kësaj Kontrate.

- i) **"Libor"** (*London Interbank Offered Rate*), përfaqëson normën e interesit për USD që publikohet në sistemin Thomson Reuters në faqen EURLIBOR, dhe që përllogaritet nga Shoqatat e Bankierëve Britanikë (*British Bankers Associations*). Informacionet në lidhje me përllogaritjen mund të gjenden në faqen: www.bbalibor.com
- ii) **"Euribor"** (*Euro Interbank Offered Rate*), përfaqëson normën e interesit, me të cilën ofrohen depozitat me afat në Euro, brenda Zonës së Euro-s, nga një Bankë Primare tek një Bankë tjetër Primare, e cila publikohet në sistemin Thomson reuters në faqen EURIBOR në orën 13:00 CET. Informacionet në lidhje me përllogaritjen mund të gjenden në faqen: <http://euribor-ebf.eu/>
- iii) **"Tribor"** (*Tirana Interbank Offered Rate*), nënkupton normën e interesit, që përllogaritet nga Banka e Shqipërisë, bazuar në kontributin e Bankave të panelit që përfaqësojnë bankat më shumë aktive në tregun e parasë në Shqipëri, në orën 12:30 ora lokale. Mesatarja aritmjetike përllogaritet bazuar në numrin e bankave kontribuese. Informacionet në lidhje me përllogaritjen mund të gjenden në faqen: www.bankofalbania.org
- iv) **"Bono Thesari"** nënkupton normën e interesit, që rezulton nga ankandi i fundit i bonove të thesarit të lëshuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Informacionet në lidhje me përllogaritjen e saj mund të gjenden në faqen www.bankofalbania.org.

"Afati Specifik i Indeksit të Normës Bazë të Interesit" nënkupton afatin e 'Indeksit të Normës Bazë të Interesit' të përzgjedhur, për të saktësuar 'Normën Bazë të Interesit'. Afati Specifik i Normës Bazë të Interesit është i ndarë (eventualisht i njëjtë ose i ndryshëm) nga afati/periudha në të cilën sikundër përcaktohet nga palët në këtë 'Kontratë' ndryshon 'Norma Bazë e Interesit'.

"Marzhi" nënkupton kuotën fikse dhe të pandryshueshme, pjesë përbërëse të Normës Vjetore të Interesit. Marzhi përllogaritet në vlerësimin e 'Normës Vjetore të Interesit', sipas përcaktimit të kësaj Kontratës.

"Norma Minimale e Interesit" nënkupton vlerën më të ulët vjetore, nën të cilën në asnjë rast nuk do të përllogaritet. **'Norma Vjetore e Interesit'**, pavarësishët se si pasojë e ndryshimeve të 'Normës Bazë të Interesit', 'Norma Vjetore e Interesit' do të rezultojë (si rrjedhojë e zbatimit të formulës: Norma Bazë e Interesit + Marzhi) në një vlerë më të vogël. Norma Minimale e Interesit do të jetë e zbatueshme vetëm nëse shprehimisht përcaktohet nga palët në nenin 2 "Kushtet e Posaçme" të kësaj Kontrate.

"Shpenzime Administrative Bankare" nënkupton shumën monetare që Kredimarrësi paguan në favor të Bankës, sipas mënyrës së rënë dakord ndërmjet palëve, për shpenzimet e Bankes lidhur me verifikimet teknike apo te nje natyre tjeter që mund te kryhen lidhur me mbarevajten e investimit.

"Tarife rishikimi vjetor", nenkupton shumen monetare që Kredimarrësi paguan në favor të Bankës, sipas mënyrës së rënë dakord ndërmjet palëve, për shpenzimet e Bankes lidhur me verifikimet teknike apo te nje natyre tjeter që mund te kryhen lidhur me mbarevajten e investimit;

"Ripagimi i Principalit" nënkupton numrin e kësteve me të cilat do të ripaguhet 'Principal', si dhe periodicitetin ose afatet e ripagimit të kësteve të 'Principalit'.

"Ripagimi i Interesit" nënkupton numrin e kësteve me të cilat do të paguhet interesit kontraktor, si dhe periodicitetin ose afatet e pagimit të kësteve të interesit.

"Kësti i Kredisë" nënkupton vlerën monetare që Kredimarrësi detyrohet të paguajë në favor të Bankës për cdo këst më vete, sipas periodicitetit apo periudhës së ripagimit të cdo kësti të principalit ose interesit, dhe që

përbëhet nga pjesa e kryegjësë plus interes. Pjesa e kryegjësë në këstet e kredisë është i shpërndarë një trajtësisht për të gjithë kohëzgjatjen e kredisë, ndërsa pjesa e interesit llogaritet mbi shumën e mbetur papaguar të kredisë.

Nësë në nenin 2 "Kushtet e Posacme" (seksioni 'Kushtet e Tjera') parashikohet shprehimisht që amortizimi i kredisë është 'French Amortization', atëherë "Kësti i Kredisë" do të përbëhet nga pjesa e kryegjësë plus interes, i shpërndarë një trajtësisht për të gjithë kohëzgjatjen e kredisë, ku interesit aplikohet mbi pjesen e papaguar te kryegjësë dhe kësti eshte i barabarte per cdo periudhe 12-mujore.

Note: Sipas koh tekstit në të cilin përdoret, nëpërmjet termit "Kësti" do të nënkuftohet "Kësti i Kredisë" ose thjesht "Kësti i Principalit" ose "Kësti i Interesit", dallimi ndërmjet të cilëve bëhet qartësisht nga konteksti në të cilin përdoret.

"Komisioni i Parapagimit" nënkupton vlerën monetare që Kredimarrësi duhet të parapaguajë në favor të Bankës, në rast parapagimi të të gjithë ose një pjesë të shumës së 'Principalit' dhe interesit të arritur deri në datën e parapagimit. Komisioni i Parapagimit mund të jetë fiks ose i ndryshueshëm përgjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, siç shprehimisht përcaktohet në nenin 2 "Kushtet e Posacme" të kësaj Kontrate.

"Norma Efektive e Interesit" (NEI) përbën totalin e kostos së kredisë për Kredimarrësin, e shprehur si përqindje vjetore e vlerës së kredisë së dhënë; dhe llogaritet bazuar në (i) supozimin që kjo kontratë është e vlefshme përfshirë afatin kontraktor dhe palët përmbytshin rregullisht detyrimet e tyre, sipas kushteve dhe mënyrës së rënë dakord në këtë kontratë; (ii) supozimin që përqindja e Normës Vjetore të Interesit dhe shpenzimet e tjera mbeten të pandryshuara (fikse) në lidhje me nivelin fillestar dhe do të mbeten të aplikueshme deri në fund të kontratës se kredisë; dhe në (iii) supozimin që shuma e Principalit të kredisë lëvróhet menjëherë dhe në total.

* Shembull i detajuar për mënyrën e llogaritjes së Normës Efektive të Interesit.

Kostoja totale e Kredimarrësit është têrësia e të gjitha shpenzimeve, duke përfshirë dhe interesat, komisionin mëjor për mirëmbajtjen e llogarisë komisionet dhe cdo lloj tjeter shpenzimi që Kredimarrësi paguan në lidhje me kontratën e kredisë sipas kushteve kontraktore. Për qëllime të llogaritjes së NEI, totali i kostos së kredisë nuk perfshin: shpenzimet që nuk njihen; shpenzimet e ndryshme nga cmimi i blerjes (nëse përfshihet në 'Qëllimin e Kredisë') nëse blerja është kryer me para në dorë ose me kredi me këste me kusht që Banka të mos jetë përfshutesi i fundit i këtyre pagesave; shpenzimet e pagueshme nga Kredimarrësi përmosbatimin e ndonjë prej detyrimeve të parashikuara në këtë kontratë; kostot e pagueshme nga Kredimarrësi lidhur me kontratën e kredisë përfshirë persona të tjera dhe cdo shpenzim në përgjithësi të detyruar përfshirë regjistrimin dhe garancitë; shpenzimet përsiguracionin dhe garancitë jo të detyrueshme; shpenzimet e komisionit të angazhimit përfshirë fondet e papërdorura; dhe shpenzimet në rast ndryshimi të afateve të pagesave të kësteve të kredisë.

"Penaliteti" nënkupton kamat-vonesat që Kredimarrësi detyrohet të paguajë në favor të Bankës, në shtojcë të detyrimeve të tjera kontraktore të tij, përi ripagimin e 'Principalit' dhe interesit kontraktor, dhe që zbatohet nëse Kredimarrësi është në vonesë përi pagimin e ndonjë shume sipas kushteve të kësaj kontrate. Penaliteti do të jetë në formën e një shtesë mbi interesin vjetor mbi shumën e papaguar, nga dita kur nis mospagesa deri në ditën e pagesës përfundimtare të shumës dhe do të llogaritet përi çdo ditë vonesë, mbi shumën e papaguar të kredisë nga ana e Kredimarrësit. Perqindja e Penalitetit rene dakort ndërmjet palëve në nenin 2 "Kushtet e Posacme" të kësaj Kontrate do t'i shohet normës së interesit kontraktor dhe totali i përqindjes që rezulton nga kjo shtese do te aplikohet ne formen e interesit vjetor mbi shumen e papaguar per të gjithë periudhen që kredimarrësi është me vonesë.

"Skeduli i Ripagimit të Kredisë" nënkupton planin e shlyerjes se pagesave, që është një dokument i ndarë nga kjo Kontratë, dhe i cili i shtrin efektet përgjatë periudhës së vlefshmërisë së tij ose deri në momentin e ndryshimit të 'Normës Vjetore të Interesit' sipas kushteve të Kontratës. Në momentin e fillimit të lëvrimit të 'Principalit', Banka dhe Kredimarrësi nënshtakuajnë Skedulin e Ripagimit të Kredisë, që konsiderohet pjesë integrale e kësaj kontrate. Në vazhdimësi përgjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate, me ndryshimin e 'Normës Vjetore të Interesit', ndryshon gjithashtu edhe Skeduli i Ripagimit të Kredisë. Skeduli i Ripagimit të Kredisë përmban 'Normën Vjetore të Interesit' të aplikueshëm sipas kushteve kontraktore përiudhën e

* Shuma e kredisë është 1000 euro, por kredimarrësit i mbahen 50 euro përi shpenzime administrative, kështu që kredia është në fakt 950 euro. Shlyerja e 1200 eurove bëhet 1.5 vjet pas marrjes së kredisë.

Ekuacioni shndërrrohet:

$$950 = 1200 / (1+i)^{547.5} / 365 = 1200 / (1+i)^{547.875} / 365.25 = 1200 / (1+i)^{18/12} = 1200 / (1+i)^{78/52}$$

Ose:

$$(1+i)^{1.5} = 1200 / 950 = 1.263157$$

$$1+i = 1.168526$$

$$i = 0.168526$$

Kjo shifër do të rrumbullakoset në 16.9% (ose 16.85 nëse preferohet një saktësi në dy shifra dhjetore).

vlefshmërisë së tij, si dhe 'Normën Efektive të Interesit', shumën e kësteve, numrin dhe datat e kësteve të parashikuara, deri në ndryshimin vijues të 'Normës Vjetore të Interesit'.

"DSCR" nënkupton reportin e mbulimit të borxhit. DSCR është reporti i mjeteve monetare të vlefshme përmbulimin e borxhit, pagimin e interesit, principalit dhe qirasë.

"DSRA" (Debt Service Reserve Account) – nenkupton një llogari rezerve e vendosur pranë Bankës së cilës sherben si garanci për pagesen e kësteve te kredise. Per qëllimin e kësaj kredie numërueshi i këtij reporti do te jetë likuiditeti i akumuluar i shoqerise duke përfashtuar fondet e mbajtura si DSRA.

"Detyrimet Specifike të Kredimarrësit" nënkupton detyrimet e Kredimarrësit përmët kryer apo përmët mos kryer një veprim të caktuar, që përcaktohet shprehimi i ndryshimit të Kontratës (apo në amendamentet, ndryshimet apo modifikimet e kësaj kontrate). Detyrimet Specifike të Kredimarrësit janë në shtojcë të detyrimeve të tjera të parashikuara përmët Kredimarrësin në këtë Kontratë.

1.02. Përcaktimet specifike të secilit nga termat e perkufizuar në nenin 1.01, paraqiten në nenin 2 "Kushtet e Posacme", sipas të cilave rregullohen edhe efektet juridike ndërmjet palëve.

NENI 2 – KUSHTET E POSACME

2.1. Palet bien dakord se kudo, ku përdoren në nenet e mëposhtme, përvèc rasteve kur shprehimi i ndryshe ndryshe në këtë Kontratë (apo në amendamentet, ndryshimet apo modifikimet e kësaj kontrate), termat e mëposhtëm do të përllogariten sipas përcaktimeve të mëposhtme:


Nr.	Kushti kontraktor	Përcaktimi	
1.	Principali	Monedha	LEKE
		Shuma	125,000,000 (njëqind e njezete e pese milionë)
2.	Disbursimi	Nr. Kësteve të lëvritimit	Sipas përcaktimeve ne seksionin me poshte
		Kushte specifike te levrimit janë si mëposhtë:	<ul style="list-style-type: none"> - Paraqitjen ne Banke te miratimeve/autorizimeve te nevojshme me shkrim te leshuara nga Autoriteti Kontraktues, Ministria e Energjise dhe Industrie si dhe nga Enti Rregulator te Energjise ("ERE") lidhur me hipotekat/pengjet/barret siguruese qe do te vendosen mbi kolateralin specifik te rene dakort mes paleve me qellim garantimin e te gjitha detyrimeve te rrjedhura per Kredimarrësin prej "Kontrates se Kredise". - Disbursimi i kredise do te behet 100% (pershire TVSH) tek furnitorët nëpërmjet transfertave bankare përkundrejt paraqitjes se faturave perkatese
3.	Periudha e Disbursimit	6 (gjashtë) muaj	
4.	Qëllimi i Kredisë	Ndertimi i Hidrocentralit MIVAS	
5.	Norma Bazë e Interesit	Indeksi i Normës Bazë të Interesit - Bono Thesari	
		Afati Specifik i Indeksit të Normës Bazë të Interesit	1 (nje) vjeçar
6.	Marzhi	3,00% (tre përqind)	
7.	Norma Minimale e Interesit	Kuota e Normës Minimale të Interesit:	5.00% (pese përqind)

8.	NEI	5.42% (pese pike dyzete e dy perqind)	
9.	Përqindja e Penalitetit	10 % (dhjete përqind)	
10.	Shpenzime Administrative Bankare	0.5% (zero pike perqind)	
11.	Tarife rishikimi vjetor	0.1% (zero pike një perqind)	
12.	Komisioni i Angazhimit	Nuk aplikohet	
13.	Konùsioni i Parapagimit	5.00 % (pese përqind)	
14.	Ripagimi i Principalit	Nr. i Kësteve	40 (tridhjete)
		Periodiciteti/Periudha i/e çdo Kësti	tremujor
		Data e fillimit të ripagimit të kësteve të Principalit	Në datën 4 të muajit 1 te 16 (gjashtembedhjete) nga data e disbursimit te kredise sipas percaktimeve ne "Skedulin e Ripagimit të Kredisë"
15.	Ripagimi i Interesit	Nr. Kësteve	42 (tridhjete e dy)
		Periodiciteti/Periudha i/e çdo Kësti	tremujor
		Data e fillimit të ripagimit të Interesit	Në datën 4 të muajit 2 te 10 (dhjete) nga data e disbursimit te kredise sipas percaktimeve ne "Skedulin e Ripagimit të Kredisë"
16.	Detyrimet specifike të Kredimarrësit	<p>Jane si me poshte:</p> <ol style="list-style-type: none"> Të mos kërkojë dhe të mos marrë asnjë kredi/hua tjetër pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës në asnjë institucion financiar apo pale e tretë; Te mos shperndaje dividente pa miratimin paraprak me shkrim te Bankes; Te ruaje per gjatë gjithe kohëzgjatjes së kredisë Raportin e Mbulimit të Borxhit ("DSCR") me te larte se 1.2 (bazuar ne likuiditetin e akumuluar, pa konsideruar DSRA); Te mos kryejë ndryshime në strukturën aktuale të zotërimit të kuotave/aksioneve të kapitalit lidhur me vendimmarrjen dhe kontrollin e shoqërisë pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës; Te marre miratimin paraprak me shkrim te Bankes per tejkalimin e shpenzimeve te investimit (CAPEX) mbi shumen e EURO 200,000 (dyqind mijë) te pambuluara nga rezervat e provigjoneve (rezervat e lidhura me përballimin e humbjeve dhe/ose shpenzimeve te paparashikuara) si dhe te financojë këto shpenzime nga ortaket e shoqërisë nëpërmjet borxhit te nënrenditur (shlyerjes paraprake te detyrimeve kundrejt Bankes) dhe/ose kapital te kontributit ("equity"); Te çele dhe mbaje prane Bankes një llogari DSRA ("Debt Service Reserve Account") llogari e cila ne çdo moment, duke filluar nga data e kësthit te pare te kredise, do te kete një fond rezerve te barabarte me vlerën e dy kësteve pasardhese te kredise; Te siguroje (ndermarre gjithë masat e nevojshme operacionale dhe ligjore) qe Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike ("OSHEE") te kanalizoje te gjitha 	

¹ Në çdo rast "Data e fillimit të ripagimit të kësteve të Principalit" do të jetë të paktën 30 ditë pas datës së disbursimit të Kredisë. Nëse data e caktuar për kryerjen e pageses bie në një ditë që nuk është ditë punë, atëherë Kredimarrësi detyrohet të kryejë këtë pagesë në ditën pasuese të punës.

² Në çdo rast "Data e fillimit të ripagimit të kësteve të Interesit" do të jetë të paktën 30 ditë pas datës së disbursimit të Kredisë. Nëse data e caktuar për kryerjen e pageses bie në një ditë që nuk është ditë punë, atëherë Kredimarrësi detyrohet të kryejë këtë pagesë në ditën pasuese të punës.





		<p>pagesat nëpërmjet llogarisë se Kredimarresit pranë Bankes;</p> <ol style="list-style-type: none"> 8. Te gjitha financimet e tashme/ardhshme te ortakeve te jene te nenrenditur ndaj shlyerjes paraprakisht te detyrimeve ndaj Bankes; 9. Te mos financoje ortaket dhe/ose palet e lidhura, perfshire subjektit "Toer Energy" dhe "HEC Kotka" duke perfshire dhe krijimin e te arketueshmeve shtese ndaj këtyre palëve (per te mënjanuar cdo lloj dyshimi te siguroje qe detyrimet e palëve te lidhura si me lart ndaj kompanisë te mbeten te pandryshuara) pa miratimin paraprak me shkrim te Bankes; 10. Te paraqese ne Banke çdo vit pasqyrat finanziare te audituara ne perputhje me standartet IFRS sa me shpejt qe te jete e mundur por ne çdo rast jo me vone se 3 (tre) muaj nga mbyllja e viti ushtrimor perkates; 11. Te ndermanre te gjitha veprimet e nevojshme qe Banka te rezultoje perfitesi i vetem i polices/ve te sigurimit ekzistuese dhe te ardhshme te hidrocentraleve; Ne cdo rast rinovimi i policave duhet te jete ne forme dhe përbajtje i pranueshëm per Banken; 12. Te paraqese ne Banke, sa me shpejt te jete e mundur por ne çdo rast minimalisht nje here ne vit, ne periudhen e rishikimit vjetor te kredise, nje raport operacional qe detajon transaksionet e kryera lidhur me projektin, te ardhurat, shpenzimet si dhe nje permblehdje te prodhimit ne hidrocentral; Raporti duhet te çertifikohet nga nje ekspert i jashtem i pranueshem per Banken; 13. Ne rast se Kredimarresi nuk do te marre Licencen per Prodhimin e Energjise Elektrike nga Enti Rregulator i Energjise ("ERE") dhe/ose do te humbasë Koncesionin, Banka do te filloje procedurat e ekzekutimit te detyrueshëm ne menyre te menjëherëshme; 14. Ne rast se Kredimarresi nuk do te lidhe Kontraten per Shitblerje te Energjise Elektrike me Operatorin e Shperndarjes se Energjise Elektrike ("OSHEE") (ose subjekt tjeter shtetëror) Banka do te filloje procedurat e ekzekutimit te detyrueshëm ne menyre te menjëherëshme; 15. Ne rast se Copri Actor nuk paguan si dhe ne rast se Kredimarresi nuk ripaguan brenda muajit Shtator 2019 detyrimet qe rrijedhin nga Kontrata e Kredise me Nr. 3887 rep/nr. 729 kol date 05.07.2012 lidhur me te arketueshmet e Copri Actor, Banka do te filloje procedurat e ekzekutimit te detyrueshëm ne menyre te menjëherëshme;
16.	Kushte te tjera	<p>Jane si meposhte:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Menyra e Amortizimit - French Amortization";

NENI 3 – PRINCIPALI

3.1. Banka bie dakort që t'i japë dhe t'i lëvroat Kredimarrësit, - me plotësimin e kushteve të 'Disbursimit', dhe në varësi të kësteve të 'Disbursimit', - shumën e 'Principalit', që do të përdoret nga Kredimarrësi për realizimin e 'Qëllimit të Kredise'.

3.2. Përveç kur palët shprehimisht kanë përcaktuar ndryshe në nenin 2 "Kushtet e Posaqme", çdo shumë e 'Principalit', do t'i lëvroat Kredimarrësit nga Banka në Llogarinë e Kredisë së Kredimarrësit pranë Bankës.

3.3. Përveç nëse shprehimisht përcaktohet ndryshe në nenin 2 "Kushtet e Posaqme", menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Kredimarrësi do të paguajë paraprakisht në favor të Bankës 'Shpenzimet administrative bankare' pagimi i të cilave kushtëzon lëvrimin e shumave të 'Principalit'.

3.4. Me qëllim që Banka të procedojë më lëvrimin e kësteve të 'Principalit', sipas dhe në përputhje me 'Disbursimin', është i nevojshëm jo vetëm plotesimi i kushteve të lëvrimit sikundër ato përcaktohen në nenin 2 "Kushtet e Posaqme" të kësaj Kontrate, por edhe përbushja e atyre detyrimeve të cilat janë të parashikuara shprehimisht në këtë Kontratë dhe që janë të lidhura me lëvrimin e shumave të 'Principalit', dhe në të gjitha rastet vetëm pasi të jetë paraqitur paraprakisht nga Kredimarrësi në Bankë:

1. Akti zyrtar i lëshuar nga autoriteti/institucioni kompetent shtetëror (Zyra e Regjistrimit te Pasurive të Paluajtshme (për rastet e vendosjes së hipotekës mbi pasuri të paluajtshme) dhe/ose Regjistri i Barrëve Siguruese (për rastet e barrësimit të pasurive të luajtshme) dhe/ose cdo institucion apo subjekt me funksione publike i parashikuar nga ligji për mbajtjen e regjistrat specifik), që vërteton se është regjistruar dhe vendosur ligjërisht në radhë të parë te preferimit (përveç kur Banka me shkrim ka pranuar një radhë të nënrenditur preferimi) garanci pasurore në favor të Bankës, për të siguruar përbushjen e detyrimeve të rrjedhura nga kjo

Kontratë, dhe se statusi/gjendja juridike e pasurisë respektive të vendosur si Kolateral është e njëjtë me atë të rënë dëkord me shkrim nga ana e Bankës;

2. Pëllimat e Sigurimit të Jetës dhe/ose të Pronës, nëse sanksionohen shprehimisht, dhe vetëm sipas dhe në përputhje të plotë me kushtet specifike të përfshira në nenin 2 "Kushtet e Posaçme" të kësaj Kontrate.

3.4.1. Banka sipas gjykimit dhe diskrecionit të vetëm të saj mund të procedojë me lëvrimin e një pjese ose të gjithë shumave të 'Principalit' edhe nëse nuk janë plotësuar kushtet apo paraqitur dokumentat për 'Dëshirsimin', sikundër përcaktohen në këtë Kontratë; megjithatë parashikohet shprehimisht se në asnjë rast një vëadim i tillë i Bankës nuk do të interpretohet si heqje dorë nga e drejta e Bankës për t'i kërkuar Kredimarrësit në një fazë të mëvonshme përbushjen e tyre dhe nëse Kredimarrësi nuk arrin t'i përbushë ato do të konsiderohet në shkelje të detyrimeve kontraktore dhe Banka jo vetëm që do të ketë të drejtë të mos kryejë lëvime të mëtejshme të shumave të 'Principalit' por do të ketë të drejtë të procedojë me kërkimin e menjëhershëm të cdo shume të lëvruar së bashku me interesat dhe penalitetet eventuale deri në ditën e shlyerjes tërësore, si dhe të fillojë procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm.

3.4.2. Pavarësish nga kushtet e lëvrimit të 'Principalit' sikundër përcaktohen në këtë Kontratë, Banka mund të vendosë të pezullojë ose refuzojë përfundimisht lëvrimin e shumave të mbetur palëvruar të 'Principalit', nëse deri në atë moment: (i) Kredimarrësi është apo ka qënë në vonesë në shlyerjen rregullisht të detyrimeve për ripagimin e kësteve të kryegjës apo interesit; ose (ii) Banka konstaton mangësi në dokumentacionin juridik apo financiar të paraqitur nga Kredimarrësi për vlerësimin e vlefshmërisë së garancive pasurore apo mundësive financiare të Kredimarrësit për kthimin e kredisë; ose (iii) Kredimarrësi nuk ka plotësuar kushtet për lëvrimin e kësteve të mëparshme, pavaresisht nëse Banka ka proceduar me lëvrimin e tyre.

NENI 4 – INTERESI KONTRAKTOR

4.1. Interesi vjetor që Kredimarrësi detyrohet t'i paguajë Bankës aplikohet me baza vjetore; numri i ditëve/360 (treqind e gjashtëdhjetë) dhe përllogaritet mbi shumën e 'Principalit'. 'Norma Vjetore e Interesit' do të jetë e barabartë me: 'Norma Bazë e Interesit' (plus) + Marzin; megjithatë duke parashikuar shprehimisht, që 'Norma Vjetore e Interesit' nuk do të konsiderohet më e vogël se 'Norma Minimale e Interesit' (nëse palët kanë përcaktuar një vlerë pozitive për 'Norma Minimale të Interesit' në nenin 2 "Kushtet e Posaçme").

4.2. 'Norma Vjetore e Interesit' është e ndryshueshme në varësi të ndryshimeve të 'Normës Bazë të Interesit' dhe/ose të 'Marzhit', sikundër përcaktohet në përkufizimet e këtyre elementeve, dhe në cdo rast ndryshimi 'Norma Vjetore e Interesit' do të kuotohet në vlerën e normës vjetore më të lartë ndërmjet: (i) 'Normës Minimale të Interesit', dhe (ii) 'Norma Bazë e Interesit' + 'Marzi'.

4.3. 'Norma Efektive e Interesit' (NEI) tregohet në nenin 2 "Kushtet e Posaçme". Në varësi të ndryshimit të 'Normës Vjetore të Interesit' sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate, apo elementeve të tjera bazë në llogaritjen e tij do të ndryshojë edhe 'Norma Efektive e Interesit'.

NENI 5 – RIPAGIMI I PRINCIPALIT DHE I INTERESAVE

5.1. Shuma e 'Principalit' do të paguhet nga Kredimarrësi, sipas numrit të kësteve të përcaktuar në 'Ripagimin e Principalit', duke filluar nga 'Data e fillimit të ripagimit të kësteve të Principalit', sipas periodicitetit apo periudhave të përcaktuar për pagimin e çdo kësti të 'Principalit' të përcaktuar në nenin 2 "Kushtet e Posaçme" të kësaj Kontrate.

5.2. Interesat kontraktorë do të paguhen nga Kredimarrësi, sipas numrit të kësteve të përcaktuar në 'Ripagimin e Interesit', duke filluar nga 'Data e fillimit të ripagimit të Interesit', sipas periodicitetit apo periudhave të përcaktuar për pagimin e çdo kësti të Interesit të përcaktuar në "Kushtet e Posaçme" të kësaj Kontrate.

5.3. Shumat dhe datat respektive të pagimit të cdo kësti (duke perfshirë pjesën e principalit dhe pjesën e interesit) përcaktohen të detajuara në 'Skedulin e Ripagimit të Kredisë', deri në momentin e ndryshimit të tij, sikundër përcaktohet shprehimisht në përkufizimin e 'Skedulit të Ripagimit të Kredisë'. Për t'u njojur me ndryshimet e 'Skedulit të Ripagimit të Kredisë', Kredimarrësi paraqitet pranë Bankës për të terhequr Skedulin e Ripagimit të Kredisë të ndryshuar, i cili nenshkruehet nga Banka dhe Kredimarrësi.

5.4. Mosrealizimi i njoftimit nga ana e Bankës për shkak të të metave apo ndryshimit të adresës së deklaruar nga ana e Kredimarrësit, apo për shkak të mosparaqitjes së Kredimarrësit për të nënskruar dhe martë nga Banka, Skedulin e ndryshuar të Ripagimit të Kredisë, nuk pengon dhe nuk kushtëzon aplikimin e ndryshimit të 'Normës Vjetore të Interesit' dhe të vlefshmerisë së Skedulit të ndryshuar të Ripagimit të Kredisë, si dhe nuk cënon detyrimet e Kredimarrësit kundrejt Bankës për ripagimin e kësteve të Principalit dhe interesave kontraktorë (të ndryshuar për rrjedhojë), dhe aplikimin e penalitetit.

Nëse 'Norma Vjetore e Interesit' do të ndryshojë sipas kushteve të përcaktuara në këtë Kontratë, atëherë në varësi të këtij ndryshimi do të ndryshojnë edhe këstet e ripagimit të kredisë të përfshira në Skedulin e ndryshuar të Ripagimit të Kredisë.

5.5. Nëse Kredimarrësi nuk paguan në kohën e duhur ndonjë shumë sipas kushteve të kësaj Kontrate, atëherë Kredimarrësi përveç detyrimeve të tjera kontrakte të përcaktuara në këtë Kontratë, do t'u pagujë Bankës edhe "Penalitetë", që përllogariten sipas përqindjes së penalitetit dhe kushteve të përcaktuara në këtë Kontratë.

NENI 6 – PARAPAGIMET

6.1 Kredimarrësi mund të parapaguajë të gjithën ose një pjesë të shumës së 'Principalit' si dhe interesin e arritur deri në datën e parapagimit, përfshirë 'Komisionin e Parapagimit', dhe që përllogaritet mbi shumën e parapagar, dhe sipas masës së përcaktuar në nenin 2 "Kushtet e Posaçme", me kusht që të njoftojë me shkrim në mënyrë të parevokueshme dhe të detyrueshme Bankët të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së parapagimit.

6.2 Çdo parapagim do të kryhet vetëm në datën e përcaktuar për pagimin e interesit, sipas 'Skedulit të Ripagimit të Kredisë', ose në një datë tjeter të miratuar nga Banka. Secili dhe të gjitha parapagimet do të përdoren kundrejt shlyerjes së kësteve të papaguara të interesit dhe 'Principalit' të kredisë, duke u përdorur fillimisht për shlyerjen e çdo shpenzimi të kryer nga Banka për ekzekutimin e detyrimeve të Kredimarrësit dhe duke vazhduar me shlyerjen e kësteve të interesit dhe/ose principalit, të cilat janë maturuar më parë.

NENI 7 – GARANCITË

7.1. Për të garantuar detyrimet e rrjedhura nga kjo Kontratë vendosen si garanci reale në favor të Bankës, pasuritë e paluajtshme dhe/ose pasuritë e luajtshme, përshkrimi i të cilave bëhet në Kontraten e Hipotekimit dhe/ose Marrëveshjen Siguruese, nëpërmjet të cilave garantohen detyrimet e Kredimarrësit të rrjedhura nga kjo Kontratë.

7.2. Në rast se do të rezultojë se një garanci pasurore e vendosur ne favor të Bankës, rrzikohet të dëmtohet apo të humbasë si rrjedhojë e të metave fizike apo juridike, të dukshme apo të fshehta ose në rast se të drejtat e Bankës mund të cënohen nga pretendimet e të tretëve mbi pronën shkaktuar nga veprimet juridike të mëparshme të disponimit mbi pronën, atëherë Banka mund të fillojë procedurat për ekzekutimin e detyrueshëm.

NENI 8 - LLOGARIA E KREDISË

8.1 Për të bërë të mundur lëvrimin e 'Principalit' si dhe më pas kryerjen e pagesave të kësteve të kredisë dhe të cdo detyrimi tjeter të rrjedhur nga kjo Kontratë, Kredimarrësi do të çelë dhe mbajë pranë Bankës, deri në shlyerjen tërësisht të cdo detyrimi kontraktor, një llogari bankare (referuar si "Llogaria e Kredisë") në mënyrën e 'Principalit'. Me Llogarinë e Kredisë, Kredimarrësi mund të kryejë edhe cdo veprim tjeter bankar; gërvëc rasteve nëse palët vendosin përfshirë specifike.

8.2. Përceljen e Llogarisë së Kredisë, ndërmjet Bankës dhe Kredimarrësit nënshkruhen aktet përkatëse te çeljes së llogarisë, në bazë të të cilave Kredimarrësi paguan kostot dhe shpenzimet e tjera sikundër përcaktohen shprehjmësht në to.

NENI 9 - PAGESAT

9.1. Të gjitha pagesat që janë maturuar dhe duhet të bëhen nga Kredimarrësi në bazë të kësaj Kontrate do të bëhen në Llogarinë e Kredisë, duke përdorur fondet që janë në dispozicion (nëse ka të tillë), në ditën e paginut të kësteve të interesit dhe/ose të kësteve të 'Principalit'. Pagesa kryhet automatikisht, nëpërmjet debitimit nga ana e Bankës, të Llogarisë së Kredisë.

9.2. Nëse data e caktuar për kryerjen e një pagesë bie në një ditë që nuk është ditë pune, dhe në Llogarinë e Kredisë nuk ka fonde te mjaftueshme për të kryer pagimin e shumës përkatëse, atëherë Kredimarrësi detyrohet të kryejë këtë pagesë në ditën pasuese të punës.

9.3. Çdo pagesë e bërë nga Kredimarrësi, pavarësisht nga natyra e kreditimit të Llogarisë së Kredisë, do të perdoret për shlyerjen e detyrimeve sipas radhës së përcaktuar më poshtë:

- a. shpenzimet dhe interesit mbi to. Në mënyrë të detajuar pagimi i shpenzimeve do të zbatohet, sipas renditjes së mëposhtme: shpenzimet për shërbim avokatë apo konsulencë tjeter të nevojshme juridike të përdorur nga Banka për mbledhjen me forcë të detyrimeve në rast vonese; shpenzimet në lidhje me ekzekutimin e detyruar të kësaj Kontrate përfshirë dhe ekzekutimin e pasurive të vendosura si garanci pasurore përfshirë detyrimet e kësaj Kontrate; shpenzime të tjera ligjore, si dhe çdo shpenzim tjeter të kryer nga Banka;

- b. pagimi i tatimeve, taksave dhe çdo shpenzimi tjeter të lidhur me këtë Kontratë si dhe interesit mbi to; intereseti i kredisë sipas renditjes së mëposhtme: intereseti i akumuluar mbi interesin, intereseti në rast mospagimi (penalitetet) dhe intereseti kontraktor; dhe
- c. shumët e kësteve të 'Principalit' të kredisë.

NENI 10 - DËKLARIMET E KREDIMARRËSIT

Banca kryesore nënshkrimin e kësaj Kontrate Kredie Bankare dhe bie dakord për dhënien e shumës së kredisë dëshkohet u bazuar mbi deklarimet dhe garancitë e dhëna nga Kredimarrësi, si më poshtë:

a. Kredimarrësi nuk ka qënë dhe nuk është në kushte insolvabiliteti (pamundësie financiare) dhe nuk është ngritur ndonjë padi kundër tij në lidhje me një fakt të tillë, nga kreditorë të tretë;

b. Dokumentacioni juridik dhe financiar i paraqitur nga Kredimarrësi, me qëllim vlerësimin e dhënies së kredisë është i vërtetë dhe i ligjshëm;

c. Deklaratat financiare të përgatitura në bazë të parimeve të kontabilitetit, janë të vërteta dhe paraqesin gjëndjen e vërtetë financiare të Kredimarrësit dhe subjekteve të lidhura me të;

d. Kontraktimi i kësaj kredie nga ana e Kredimarrësit nuk bie në kundërshtim me ndonjë ligj, akt nënligjor apo kufizim kontrator që Kredimarrësi është i detyruar të respektojë;

e. Kjo kontratë përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjërisht të detyrueshëm për zbatim nga Kredimarrësi në përputhje me kushtet e parashikuara në të;

f. Nuk ekzistonjë padi, ose procedura të filluara para gjykatave ose organeve administrative, të cilat mund të kenë një ndikim negativ ndaj biznesit apo gjëndjes financiare të Kredimarrësit apo subjekteve të lidhur me të, dhe/ose ndaj kompetencës së tij për të lidhur dhe ekzekutuar këtë Kontratë, dhe /ose ndaj pronave që vendosen si garanci pasurore në favor të Bankës;

g. Nuk ka asnjë çështje në proces ose konflikte të natyrës që mund të cënojnë interesat e Bankës;

h. Pasuritë e paluajtshme dhe/ose të luajtshme, që vendosen si garanci pasurore në favor të Bankës, janë te lira nga cdo masë sekuestro dhe/ose kufizim dhe/ose barrë e një radhe më të lartë preferimi, përvèc sa shprehimisht eshte rënë dakord nga ana e Bankës në Kontraten e Hipotekimit dhe/ose Marrëveshjen Siguruese përkatëse, dhe hipotekuesi apo barrëdhënsi kanë pronësi të plotë, të drejtë gjëzimi dhe disponimi mbi to;

i. Kredimarrësi deklaron se ka marrë vendimin për lidhjen e kësaj kontrate, pasi ka shqyrtuar, kuptuar dhe pranuar, kushtet e kësaj kredie, që i jane paraqitur Kredimarrësit nga ana e Bankës në formën e informacionit standard parakontraktor;

j. Kredimarrësi deklaron se, është vënë në dijeni nga ana e Bankës, dhe se kupton dhe merr përsiper trezikon e humbjeve që mund të shkaktohen për të, si rrjedhojë e ndryshimeve të kursit te këmbimit të monedhës së 'Principalit' me monedhën vëndase Lek-un (nëse të ndryshme);

k. Kredimarrësi deklaron se, është vënë në dijeni nga ana e Bankës, dhe se kupton dhe merr përsiper trezikon e humbjeve që mund të shkaktohen për të, si rrjedhojë e rritjes së normës së interesit vjetor kontraktor, pasojë e rritjes së Normës Bazë të Interesit përgjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate.

l. Kredimarrësi deklaron se ka dijeni dhe ka kuptuar plotësisht 'Normën Vjetore të Interesit', 'Penalitetet' për rastet e mosekzekutimit në afat të detyrimeve kontraktuale, ndryshueshmërinë e 'Normës Vjetore të Interesit', 'Komisionin e Parapagimit' si dhe koston totale të kredisë, si dhe mënyrën dhe formulën matematike të llogaritjes së NEI, sipas përcaktimit të Rregulloren "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare" miratuar me Vendimin nr. 59, date 29.08.2008 të Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë;

m. Kredimarrësi deklaron se është vënë në dijeni të avantazheve dhe disavantazheve, që shqyrojnë marrjen e këtij lloji kredie dhe qëllimin e kredisë;

n. Kredimarrësi kupton dhe bie dakord që në vazhdimësi përgjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, me ndryshimin e normës vjetore të interesit ndryshon automatikisht edhe Skeduli i Ripagimit te Kredisë;

o. Kupton dhe pranon se mosrealizimi i njoftimit nga ana e Bankës për shkak të të metave apo ndryshimit të adresës së deklaruar nga ana e Kredimarrësit, apo për shkak të mosparaqitjes së Kredimarrësit për të nënshkruar dhe marrë nga Banka, Skedulin e ndryshuar të Ripagimit të Kredisë, nuk pengon dhe nuk kushtëzon aplikimin e ndryshimit të 'Normës Vjetore të Interesit' dhe ose të vlefshmerisë së Skedulit të ndryshuar të Ripagimit të Kredisë, si dhe nuk cënon detyrimet e Kredimarrësit kundrejt Bankës për pagimin e kësteve të ndryshuar të Principalit dhe interesave kontraktorë, dhe aplikimin e penalitetit.

NENI 11 - DETYRIMET E KREDIMARRËSIT

Gjatë të gjithë periudhës që nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate deri në datën e ripagimit të plotë të cdo detyrimi lidhur me këtë Kontratë, Kredimarrësi do të:

1. Paguajë 'Principalin' dhe interesat kontrakte, në përpunhje me numrin e kësteve, perdicitetin/periudhën e cdo kësti, brenda afateve specifike për cdo këst dhe sipas mënyrës së percaktuar në Kontratë, të 'Ripagimit të Principalit' dhe 'Ripagimit të Interesit';

2. Përdorë shumën e 'Principalit' vetëm për realizimin e 'Qëllimit të Kredisë';

3. Përbushë 'Detyrimet Specifike të Kredimarrësit', sikundër parashikohen në nenin 2 "Kushtet e Posaçme" të kësaj Kontrate;

4. Mbulojë të gjitha shpenzimet e kryera nga Banka për regjistrimet e garancive pasurore në favor të Bankës, në organet kompetente, dhe për këtë arsyë autorizon shprehimisht Bankën të kryeje debitimet përkatëse nga Llogaria e Kredisë dhe/ose nga llogaritë e tjera të tij pranë Bankës;

5. Kryejë, vetëm nëse shprehimisht parashikohet në nenin 2 "Kushtet e Posaçme", sigurimet e pronave të vendosura si garanci pasurore me përfitues sigurimi Bankën; si dhe të kryejë sigurimin e jetës me përfitues Bankën për të gjithë kohëzgjatjen dhe shumën e Kredisë. Primi i sigurimit do të përllogaritet për të gjithë kohëzgjatjen e kredisë dhe sipas kërkeseve specifike të Bankës duhet të paguhet menjëherë në momentin e nënshkrimit të kontratës së sigurimit ose me këste vjetore të shpërndara përgjatë kohëzgjatjes së kontratës së sigurimit. Në rast vonese/refuzimi të Kredimarrësit për pagimin e këstit të primit te sigurimit të jetës dhe/ose pronës, Banka mund, - por pa qënë e detyruar për këtë, - të kryejë vetë pagimin e këstit të primit vjetor të sigurimit duke debituar me iniciativën e saj Llogarinë e Kredisë dhe/ose cdo llogari tjeter të Kredimarrësit pranë Bankës duke kaluar llogarinë në overdraft nëse nuk ka fonde të mjaftueshme në llogari;

6. Për t'u njohur me ndryshimet e Skedulit të Ripagimit të Kredisë, në rastet e ndryshimit të tij të percaktuar në Kontratë, Kredimarrësi do të paraqitet pranë Bankës [jo më pak se një herë në 12 (dymbëdhjetë) muaj] për të marrë dhe nënshkuar Skedulin e Ndryshuar të Ripagimit të Kredisë;

7. Paguajë çdo muaj komisionet për mirëmbajtjen e Llogarisë së Kredisë, dhe për këtë arsyë Banka mund të kryejë debitimin automatik të Llogarisë së Kredisë;

8. Mbulojë të gjitha pagesat për noterizimin e kësaj Kontrate dhe kontratave nëpërmjet të cilave garantonë detyrimet e Kredimarrësit; si dhe për raportet e vlerësimit të pronave kolateral, përgatitur nga eksperti të licensuar;

9. Kredimarrësi detyrohet që deri në përfundim të kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, dhe sipas kërkësës së Bankës, por në asnjë rast jo më shumë se një herë në çdo tre vjet, të lejojë dhe bëjë të mundur aksesin e ekspertit vlerësues të përzgjedhur nga Kredimarrësi nga lista e publikuar e Vlerësuesve të Jashtëm që Banka i vë në dispozicion, për të kryer ri-vlerësimin e pasurive të paluajtshme të vendosura si garanci pasurore për shlyerjen e detyrimeve monetare të rrjedhur nga kjo Kontratë, si dhe të shlyejë ekspertin vlerësues respektiv për shpenzimet lidhur me reportin e ri-vlerësimit të pasurive që dorezohet në Bankë;

10. Njoftojë Bankën me shkrim për çdo padi të ngritur kundër tij dhe që ka lidhje me një detyrim të caktuar financiar të tij, apo që cënon titullin e pronësisë së pasurisë së lënë garanci pasurore.

11. Mba jë gjithmonë të gjitha të dhënat financiare të aktivitetit tregtar në libra e regjistra, duke i bërë të mundur Bankës të ketë menjëherë dijeni për to sa herë që do ta gjykojë të nevojshme.

12. Paraqesë cdo vit në Bankë pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe bilancin e aprovar nga eksperti kontabël në përfundim të vitit ushtrimor financiar, si dhe të njoftojë menjëherë çdo ndryshim të statutit dhe/ose të selisë (nëse Kredimarrësi është person juridik).

13. Paraqesë me kërkësë të Bankës, në mënyrë periodike, konfirmimet e organeve financiare, në lidhje me kryerjen e pagimeve të tatimeve dhe/ose të taksave.

14. Njoftojë Bankën për ndodhjen e çdo Rasti Shkakësor ose çdo ngjarje që mund të përbëjë Rast Shkakësor (për ekzekutim të detyrueshëm), duke dhënë shpjegimet e nevojshme.

15. Njoftojë Bankën me shkrim për çdo padi të ngritur kundër tij dhe që ka lidhje me një detyrim të caktuar finansiar të tij, apo që cënon titullin e pronësisë së pasurisë së vendosur si garanci hipotekore, peng dhe/ose barrë siguruese, dhe në mënyrë të menjëherësme të ndërmarrë çdo veprim ligjor që Banka mund t'ia rekomandojë atij.

16. Përbushë dhe respektojë cdo detyrim të percaktuar në këtë Kontratë.

NENI 12 – EKZEKUTIMI I DETYRUESHËM DHE RASTET SHKAKËSORË

12.1. Banka mund të fillojë procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm në mënyrë të njëanshme dhe të menjëherësme në rast se ndodh të paktën një nga shkaqet (referuar si "Rastet Shkakësore") si më poshtë vijon:

a. Nëse Kredimarrësi nuk i paguan Bankës ndonjë shumë të maturuar dhe është në vonesë në pagimin e ndonjë kësti të 'Principalit' dhe/ose interesit në kohën e duhur, më specifikisht: (i) në rastet kur Kredimarrësi nuk përbush detyrimin e pagimit të dy kësteve të njëpasnjëshme të principalit dhe/ose interesit, (ii) ne rastet kur Kredimarrësi është në vonesë për më tepër se 90 (nëntëdhjetë) ditë nga data e pagimit të një kësti principali ose interesit.

b. Nëse Kredimarrësi nuk përdor shumën e 'Principalit' për realizimin e 'Qëllimit të Kredisë';

c. Nëse Kredimarrësi shkel ndonjë nga detyrimet e tjera sipas kësaj Kontrate dhe/ose akti ligjor apo nënligjor të zbatueshëm;

d. Nëse ndonjë nga deklarimet dhe/ose garancitë, do të rezultojë të jetë jo i vërtetë;

e. Nëse zbulohet që pasuria e paluajtshme ose e luajtshme, e cila vendoset si garanci pasurore në favor të Bankës, ka qënë e vendosur në hipotekë ose peng/barrë siguruese në favor të subjekteve të tretë, dhe Banka nuk është vënë në dijeni për këtë fakt përparrë fillimit të lëvrimit të ‘*Principalit*’;

f. Nëse sipas urdhërit ose vendimit të ndonjë autoriteti shtetëror, pasuria e lënë në hipotekë ose peng/barrë siguruese për të garantuar plotësimin e detyrimeve të Kredimarrësit rrijedhur nga kjo Kontratë, - sekuestrohet, konfiskohet ose në një mënyrë tjetër cënohet;

g. Nëse kundrejt Kredimarrësit ka filluar një procedurë ekzekutimi të detyrueshëm për ndonjë detyrim kundrejt një personi të tretë, detyrim ky për të cilin Banka nuk është vënë në dijeni nga Kredimarrësi përparrë dhënies së kësaj kredie;

h. Nëse Kredimarrësi është person juridik dhe kanë filluar procedurat përfalimentimin, likujdimin, shkrirjen, bashkimin, ndarjen e Kredimarrësit (ose çdo procedurë tjetër, e pezulluar ose përfilluar në të ardhmen, e zbatueshme ndaj debitorëve që nuk kanë shlyer detyrimet).

i. Nëse ka pasur një ndryshim në strukturën aktuale të zotërimit të kuotave/aksioneve të kapitalit të Kredimarrësit (nëse Kredimarrësi është person juridik) lidhur me vendimmarrjen dhe kontrollin e shoqërisë, pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës.

j. Nëse Kredimarrësi është i përfshire në një proces gjyqësor që ka lidhje me aksionerët, ortakët, tagrat e përfaqësimit të dhëna administratorëve të shoqërisë dhe kompetencat e organeve vendimmarrëse të shoqërisë.

k. Nëse Kredimarrësi braktis biznesin, në funksion të të cilët është dhënë kredia ose Hipotekuesi apo Pengdhënësi/Barrëdhënësi braktis pasurinë e vendosur si kolateral përfshirë detyrimeve të kësaj Kontrate.

l. Nëse vendoset masë sekuestrimi ose masë tjetër ndaj pasurisë së Kredimarrësit ose pjese të rëndësishme të saj.

m. Nëse Kredimarresi nuk do te marre Licencen per Prodhimin e Energjise Elektrike nga Enti Rregulator i Energjise (“ERE”) dhe/ose do te humbasë Koncesionin;

n. Ne rast se Kredimarresi nuk do te lidhe Kontraten per Shitblerje te Energjise Elektrike me Operatorin e Shperndarjes se Energjise Elektrike (“OSHEE”) (ose subjekt tjetër shtetëror);

o. Ne rast se Copri Actor nuk paguan si dhe ne rast se Kredimarresi nuk ripaguan brenda muajit Shtator 2019 detyrimet që rrijedhin nga Kontrata e Kredise Nr 3887 rep/kol 729.date 05.07.2012 lidhur me te arketueshmet e Copri Actor;

12.2. Në rast se rezulton ndonjë nga ‘Rastet Shkakësorë’, atëherë Banka do të ketë të drejtë të pezullojë ose refuzojë përfundimisht lëvrimin e shumave të mbeturat palëvruar të ‘*Principalit*’.

12.3. Kjo Kontratë përbën titull ekzekutiv sipas klasifikimit të nenit 510 shkrronja “d” të Kodit të Procedurës Civile, dhe përkëtë arsyë në rast se do të ndodhë ndonjë nga ‘Rastet Shkakësorë’, atëherë Banka sipas gjykimit dhe diskrecionit të saj të vetëm, do të ketë të drejtë të kërkojë pagimin e menjëherëshëm të të gjithë detyrimeve, duke përfshire pagimin e të gjithë ‘*Principalit*’, interesave kontraktore, penalitetëve dhe, çdo shpenzim tjetër. Nëse pagimi i plotë i shumës së detyrimeve nuk kryhet nga Kredimarrësi brenda 10 (dhjete) diteve nga dita kur ndodh një prej ‘Rasteve Shkakësorë’, atëherë Banka do të ketë të drejtë të fillojë procedurat e ekzekutimit te detyrueshëm, duke kërkuar fillimisht nga Gjykata kompetente lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit përfshirë tjetër Kontratë, dhe më pas të vazhdojë procedurat përkatëse përmbarimore të ekzekutimit të detyrueshëm. Banka nuk është e detyruar të njoftojë Kredimarrësin lidhur me fillimin e më pas mbarimin e afatit 10 ditor të përcaktuar në këtë paragraf, pasi detyrimi bëhet i kërkueshëm sipas kushteve specifike të kësaj Kontrate.

12.3.1. Me lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit dhe fillimin e procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm, do të aplikohen kamatat përfshirë pagesat e vonuara në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe legjislacionit në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare.

12.3.2. Çdo shkresë e lëshuar nga Banka, si dhe dëftesat e gjeneruara nga sistemi kompjuterik i Bankës, në lidhje me detyrimin monetar të Kredimarrësit në një moment të caktuar, duke përfshire pjesën e ‘*Principalit*’ të papaguar, interesat kontraktore dhe penalitetet si dhe detyrime të tjera monetare në bazë të kushteve të kësaj ‘Kontrate’, do të kenë fuqi të plotë provuese.

Pavarësisht nga shuma totale e detyrimit, - ashtu sikundër ky detyrim rezultonte në momentin e lëshimit të Urdhërit të Ekzekutimit, apo fillimit të procedurave përmbarimore, - Kredimarrësi është në dijeni dhe pranon se në përfundim të procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm, Banka do të ketë të drejtë të deklarojë vlerën e detyrimeve totale të Kredimarrësit në atë moment, dhe përfshirë pjesën e mbetur të pashlyer të kërkojë nga shërbimi përmbarimor (shtetëror apo privat), vazhdimin e procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm.

12.3.3. Banka do të ketë të drejtë (dhe jo detyrim), që në rast të ndodhjes së ndonjë ‘Rasti Shkakësor’, të bëjë menjëherë, me iniciativën e saj bllokimin, dhe më pas debitimin e llogarive të Kredimarrësit pranë Bankës, deri në vlerën e shlyerjes totale të detyrimeve të kësaj ‘Kontrate’. Në këtë kuadër, Banka do të ketë të drejtë që për efekte të kompensimit ose ekzekutimit të detyrimeve të Kredimarrësit, të kryejë konvertitë të çdo shume detyrimi të papaguar të Kredimarrësit nga monedha ose kundrejt monedhës në të cilën shprehet shuma e ‘Principalit’, me kursin përkatës të Bankës në datën kur bëhet konvertimi. Kredimarrësi i transferon Bankës të drejtë privilegji mbi shumat monetare që do të ndodhen në llogari, dhe pranon në mënyrë, të parevokueshme veprimet e Bankës sipas këtij nenit.

12.4. Përvet rasteve të parashikuara shprehimisht në ligj apo në aktet nën-ligjore të zbatueshme, Kredimarrësi nëpërmjet kësaj Kontrate, jep pëlqimin në mënyrë të parevokueshme se në rast mospërbimëshje detyrimesh kontraktore, Banka në kuadër të rikuperimit të kredisë, pavarësisht nëse ka ndërmarrë ose jo veprimet proceduriale përbirimore, do të ketë të drejtë të përhapë, transferojë dhe/ose të përpunojë të dhënat personale dhe financiare të Kredimarrësit, me cdo subjekt tjetër, në kuadër të vlerësimit paraprak apo realizimit të kalimit të Kontratës (nëpërmjet shitjes apo forma të tjera të disponimit, me ose pa shpërblim), më vete ose si pjesë të një portofoli kredish, tek subjekte të tretë, sipas kuadrit ligor të zbatueshëm.

NENI 13 - AUTORIZIM PËR TRAJTIMIN E TË DHËNAVE NËPËRMJET REGJISTRIT TË KREDISË

Në zbatim të nenit 127 të Ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 67 datë 13.10.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për përbajtjen e informacionit dhe funksionimin e regjistrat te kredive në Bankën e Shqipërisë” të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, Kredimarrësi nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Kontrate: (i) deklaron se i gjithë informacioni i dhënë prej tij është i saktë dhe i plotë, si dhe (ii) duke kupuar se, të dhënat demografike, dhe financiare të ruajtura në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë do të trajtohen në përputhje me kuadrin ligor dhe nënligor në fuqi për mbrojtjen e të dhënavë personale, sekretin bankar si dhe sekretin profesional, si dhe përfaktin se “Intesa Sanpaolo Bank Albania” SH.A dhe Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë kanë marrë të gjitha masat e nevojshme përfshirë garantuar trajtimin e sigurt të të dhënavë të Kredimarrësit, autorizon “Intesa Sanpaolo Bank Albania” SH.A, që përfshirë qëllimet që përfshijnë: 1. vlerësimin e aplikimit përfshirë marrë kredi; 2. vlerësimin e rrezikut të kredisë gjatë të gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënieve kontraktore të kredisë me “Intesa Sanpaolo Bank Albania” SH.A; 3. vlerësimin e besueshmërisë së Kredimarrësit së bashku me personat e tretë të lidhur me Kredimarrësin; të nqyhet me detyrimet e Kredimarrësit ndaj bankave/degëve të bankave të huaja/subjekteve kredidhënëse, nëpërmjet përpunimit të autorizuar të të dhënavë/informacionit të Regjistrat të Kredive, në mënyrë që të vlerësojë sasinë e detyrimeve financiare, garancitë dhe besueshmërinë/astësinë përfshirë shlyer detyrimet financiare. Gjithashtu, Kredimarrësi jep pëlqimin që “Intesa Sanpaolo Bank Albania” SH.A të përdorë emërin dhe të dhënat identifikuuese dhe financiare të Kredimarrësit që mbahen në Regjistrin e Kredive, përfshirë kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë.

NENI 14 - AUTORIZIM PËR TRAJTIMIN E TË DHËNAVE NËPËRMJET SHOQËRISË MËMË

Sipas Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënavë personale” dhe Ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, Kredimarrësi në mënyrë të parevokueshme autorizon “Intesa Sanpaolo Bank Albania” Sh.a të transferojë dhe të trajtojë të gjitha të dhënat personale dhe financiare të tij (më poshtë referuar “Informacion Konfidencial”) me dhe tek Shoqeria Mëmë e saj: “Intesa Sanpaolo” S.p.A, nëse dhe sa herë që kërkohet nga Shoqeria Mëmë: “Intesa Sanpaolo” S.p.A. Kredimarrësi, duke kupuar se të dhënat e tij personale dhe financiare do të trajtohen në përputhje me kuadrin ligor dhe nënligor në fuqi përfshirë qëllimet që përfshijnë: 1. vlerësimin e aplikimit përfshirë marrë kredi; 2. vlerësimin e rrezikut të kredisë gjatë të gjithë afatit të marrëveshjes kontraktore të kredisë me “Intesa Sanpaolo Bank Albania” SH.A; 3. vlerësimin e besueshmërisë së Kredimarrësit së bashku me palët e tretë të lidhura me Kredimarrësin; 4. mbikëqyrjen e konsoliduar nga Shoqëria Mëmë: “Intesa Sanpaolo” S.p.A [duke përfshirë por pa u kufizuar tek qëllimet e konsolidimit të pozicioneve të mëposhtme: (a) kapitalin rregullator, (b) mjaftueshmërinë e kapitalit, (c) ekspozimi i rrezikut, (d) pozicionet e hapura të këmbimeve valutore, (e) investimet në institucionet kapitale dhe jo kapitale]; 5. monitorimi dhe procesi i administrimit të rreziqeve të Bankës dhe rrezikut të Grupit Bankar Intesa Sanpaolo, ose me konsolidimin e pozicioneve që parashikohen në Ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, - përfshirë qëllimet që përfshirë rrezikun e dështimit të detyrimeve financiare, duke përfshirë kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë.

S.p.A. Në përputhje me sa më sipër, Kredimarrësi autorizon "Intesa Sanpaolo" S.p.A të ketë akses, të përdorë dhe të trajtojë të dhënat personale dhe financiare që zotëron "Intesa Sanpaolo Bank Albania" Sh.a dhe/ose kjo e fundit merr në zotërim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu pranohet se i gjithë Informacioni Konfidencial do të mbrohet përparrë keqpërdorimit, dëmtimit, shkatërrimit, zhvlerësimit, humbjes dhe vjedhjes dhe "Intesa Sanpaolo" S.p.A nuk do të përdorë Informacionin Konfidencial për asnjë qëllim tjetër përvëçse për qëllimet që përcaktohen më sipër, si dhe nuk do t'i zbulohen, vihen në dispozicion, publikohen ose përhapen palëve të treta. "Intesa Sanpaolo" S.p.A do të sigurojë që vetëm personat periegjës (duke përfshirë Nën-kontraktorët dhe Filialët) të cilëve u zbulohet informacioni në funksion të përbushjes së qëllimeve të parashikuara më sipër, do të kenë akses të Informacionit Konfidencial. Informacioni Konfidencial mund të zbulohet deri në masën e parashikuar me ligj, gjykatës, zyrës së prokurorisë dhe organeve të tjera kompetente, që gëzojnë këtë të drejtë në bazë të ligjit dhe rregulloreve të zbatueshme, një gjykatës ose çdo autoriteti rregulator. "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SH.A dhe Shoqeria Mëmë e saj: "Intesa Sanpaolo" S.p.A do të sigurojnë respektimin nga ana e Personelit të saj (duke përfshirë Nënkontraktorët dhe Filialët) te detyrimeve për konfidencialitetin e marrë përsipër.

NENI 15 - USHTRIMI I TË DREJTAVE – NDRYSHIMET E KONTRATËS – PAVLEFSHMËRIA E PJESSHME – KALIMI I KONTRATËS

15.1. Asnjë veprim dhe asnjë vonesë në ushtrimin e të drejtave të ligjshme ose kontraktuale, në 'Rastet Shkakësore' sipas kësaj Kontrate, nuk do të ndikojë dhe interpretohet si heqje dorë nga të drejtat e Bankës për ekzekutimin e detyrueshëm.

15.2. Çdo ndryshim i kësaj Kontrate do të kryhet me miratimin e dhënë në formë shkresore nga palët kontraktore. Asnjë ndryshim në dispozitat e kësaj Kontrate nuk ka fuqi në rast se nuk është pranuar me shkrim midis palëve.

15.3. Në rast se ndonjë klauzolë që detyrim sipas kësaj Kontrate do të jetë apo shpallet e pavlefshme, e kundërligjshme ose e pazbatueshmë, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e klauzolave ose e detyrimeve të tjera të parashikuara në këtë Kontratë, nuk do të cënohen apo ndikojnë në zbatim.

15.4. Banka ka të drejtë që të cedoje tek personat e tretë, tjerësish ose pjesërisht, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo Kontratë, në bazë të gjykimit dhe vendimit të saj. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Kredimarrësi jep pëlqimin e miraton shitjen, transferimin e cedimin e të drejtave që Banka rezervon në bazë të kësaj Kontrate tek personat e tretë.

Kredimarrësi deklaron se kuption dhe pranon që Banka do të mund të disponojë lirisht dhe të kaloj Kontratën, me ose pa shpërblim, më vete ose si pjesë të një portofoli kredish, tek subjekte të tretë, sipas kuadrit ligjor të zbatueshem, dhe pavarësisht nëse Kredimarrësi ndodhet ose jo në kushtet e mospërbushjes së detyrimeve kontraktore. Për të bërë të mundur realizimin e këtij cedimi të drejtash apo kalimi kontrate, sipas Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kredimarrësi në mënyrë të parevokueshme autorizon Bankën t'i japë të dhënat personale dhe financiare të tij si dhe informacione me karakter ligjor dhe ekonomik, të nevojshme përparrë, gjatë dhe pas lidhjes së Marrëveshjes së Cedimit (duke perfshirë edhe, por pa qënë i kufizuar në shitjen apo në një formë tjetër të disponimit të kontratës) kujtido pale me të cilën Banka deshiron të hyjë në këtë marrëdhënie cedimi apo kalimi kontrate.

Kredimarrësi bie dakord të pranojë dhe ekzekutojë të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Kontrate kundrejt palës së tretë, në përputhje me Marrëveshjen e Cedimit apo Kalimit te Kontratës.

NENI 16 – NJOFTIMET

16.1. Çdo njoftim, kërkësë ose komunikim tjetër sipas kësaj kontrate ndaj Bankës ose Kredimarrësit do të jepet vetëm me shkrim dhe ato do të dergohen për sa i takon qoftë Bankës ose Kredimarrësit, në adresat e specifikuara në këtë Kontratë, ose në adresë të tjera ku pala në fjalë e përcakton dhe njofton me shkrim palën tjetër në lidhje me të.

16.2. Kredimarrësi kuption dhe bie dakord që për rastet kur njoftimi nuk është i realizueshëm për shkaqe të pavarura nga Banka, atëherë detyrimi për informim nga Banka do të konsiderohet i kryer, duke përdorur një nga format vijuese të zgjedhur nga Kredimarrësi: (i) me shkrim dërguar në adresën personale postare të Kredimarrësit në Bankë, ose (ii) në formë elektronike nëpërmjet e-mail ose mesazhi telefonik në adresat apo numrat e kontaktit të deklaruara nga vetë Kredimarrësi në Bankë.


NENI 17 – LEGJISLACIONI DHE JURIDIKSIONI MBIKQYRËS

Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me Legjislacionin Shqiptar dhe çdo mosmarrëveshje, keqkuptim ose pretendim që mund te lindë për këtë kontratë ose në lidhje me të do të gjykohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë.

NENI 18 - NENSHKRIMI I KONTRATES

Kjo Kontratë Kredie Bankare u hartua në 3 (tre) kopje të njëjtë e të barazvlefshme në gjuhën shqipe. Secila nga palët mban nga një kopje; dhe një kopje e Kontratës mbahet në Zyrën Notierale. Interpretimi i kushteve kontraktore do të bëhet në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm dhe qëllimin e palëve për të lidhur këtë Kontratë.

Unë Noterja, ua lexova me zë të lartë palëve tekstin e kësaj Kontrate dhe i njoftoja palët me efektet ligjore të saj ato më deklaruan se e kuptojnë atë, konstatova se palët e gjejnë Kontratën në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe te plotë, dhe Unë Noterja i vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjit.


KREDIDHENESI

Jonida Cule

KREDIMARRESI**“ELVA 2001” SHPK**

Perfaqësuar nga

Mihal Hudhra

NOTERE


Në përputhje me Nenin 686 të Kodit Civil shqiptar, Unë/ne deklaroj(jmë) shprehimisht se kam (kemi) lexuar, kuptuar dhe pranuar klauzolat e mëposhtme të kësaj Kontrate: Neni 1 (Perkuçizime); Neni 2 (Kushtet e Posaçme); Neni 4 (Interesi Kontraktor); Neni 12 (Ekzekutimi i Detyrueshëm dhe Rastet Shkakësorë); Neni 15.4 (Kalimi i Kontratës)

Tiranë/17/10/2019**KREDIMARRESI****“ELVA 2001” SHPK**

Perfaqësuar nga

Mihal Hudhra

